



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKU KOSOVA
STATISTICAL AGENCY OF KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Statistical Agency of Kosovo

PROGAMI I STATISTKAVE ZYRTATRE 2024-2028

Prishtinë, Qershor 2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Statistical Agency of Kosovo

PROGAMI I STATISTIKAVE ZYRTATRE

2024-2028

Përmbajtja

Faqe

1.	Përmbledhje Ekzekutive.....	4
2.	Hyrje	6
3.	Procesi i hartimit të Programit të Statistikave Zyrtare	7
3.1	Metodologjia	7
4.	Analizë e situatës /Gjendja/	8
4.1	Qasja institucionale	8
A)	Buxheti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës.....	9
B)	Personeli i Agjencisë së Statistikave të Kosovës.....	10
C)	Qasja e integruar e Agjencisë së Statistikave të Kosovës.....	11
D)	Bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare	11
E)	Mbështetja e ASK nga donatorë të jashtëm	13
F)	Mekanizmat mbikëqyrës	13
4.2	Zhvillimi i politikave i bazuar në të dhëna	14
A)	Efikasiteti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës	15
➤	Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave	18
➤	Regjistrimi i Bujqësisë.....	18
➤	Statistikat Sociale dhe të Popullsisë.....	18
➤	Llogaritë kombëtare	19
➤	Statistikat ekonomike	20
➤	Statistikat e Bujqësisë.....	20
➤	Statistikat e Ministrisë përgjegjëse të Financave.....	20
➤	Statistikat e Bankës Qendrore.....	21
➤	Statistikat e Institucioneve tjera.....	22
➤	Sfidat e Statistikave zyrtare	22
5.	Objektivat Strategjike të Programit të Statistikave Zyrtare 2024-2028	23
➤	Objektivi Strategjik 1. Avancimi i kapaciteteve institucionale dhe modernizimi i proceseve përmes digjitalizimit	25
➤	Objektivi Strategjik 2. Fuqizimi i koordinimit dhe bashkëpunimit institucional.....	29
	në sistemin e statistikave të Kosovës.....	29
➤	Objektivi Strategjik 3. Rritja e numrit dhe frekuencës së Statistikave Zyrtare	34
	të Kosovës	34

➤	Objektivi Strategjik 4. Rritja e cilësisë dhe besueshmërisë së Statistikave Zyrtare nëpërmjet harmonizimit të mëturjes me standardet ndërkombëtare	36
6.	Aranzimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit	40
➤	Koordinimi institucional	40
➤	Monitorimi dhe raportimi i Programit.....	41
➤	Vlerësimi i ndërmjetëm dhe përfundimtar i Programit.....	41

1. Përmbledhje Ekzekutive

Programi i Statistikave Zyrtare, duke u bazuar në Ligjin për Statistikat Zyrtare dhe nevojën për të avancuar më tutje Sistemin Statistikor të vendit, paraqet objektivat dhe prioritetet të cilat do të zbatohen përgjatë periudhës së ardhshme pesëvjeçare.

Sistemi Statistikor i Kosovës (SSK), tashmë është sistem i konsoliduar, pothuajse në shumicën e komponentëve të tij. Duke u bazuar në vlerësimet e jashtme, në veçanti Raportit të Vendit të Komisionit Evropian për Kosovën, konsiderohet se Kosova ka arritur një nivel të duhur të përgatitjes në fushën e statistikave. Në këtë drejtim është bërë progres veçanërisht në përmirësimin e metodologjisë së mbledhjes së të dhënave dhe transmetimit të tyre në Eurostat. Gjithashtu, edhe korniza ligjore është në përgjithësi në përputhje me Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane. Megjithatë, kërkohet që më tutje të avancohet Sistemi Statistikor me qëllim të përafrimit të statistikave sektoriale me Standardet Evropiane si dhe të sigurohet ofrimi i produkteve të reja statistikore.

Për të adresuar sfidat ekzistuese dhe me qëllim të avancimit të mëtutjeshëm të SSK, përmes këtij dokumenti, ASK, në bashkëpunim me bartësit tjerë të Statistikave Zyrtare paraqet vizionin dhe objektivat strategjike dhe specifike të cilat udhëheqin Statistikat Zyrtare për pesë vitet e ardhshme. Prandaj, ky Program Strategjik synon zgjerimin e gamës dhe cilësinë e prodhimit të statistikave, duke u bazuar kryesisht në një ndërveprim sistematik me përdoruesit në kuptimin e efektshme-risë dhe dobisë së Statistikave Zyrtare për politikë bërjen, për zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit si dhe relevancën e tyre te organizatat ndërkombëtare.

Për të arritur këtë vizion, Programi i Statistikave Zyrtare është i fokusuar në katër objektiva strategjike:

1. Avancimi i kapaciteteve institucionale dhe modernizimi i proceseve përmes digjitalizimit;
2. Fuqizimi i koordinimit dhe bashkëpunimit institucional në Sistemin e Statistikave të Kosovës dhe rritja e qasjes në burime administrative;
3. Shtimi i numrit të produkteve statistikore dhe shkurtimi i afatit të prodhimit;
4. Rritja e cilësisë dhe besueshmërisë së statistikave nëpërmjet harmonizimit të mëtutjeshëm me standardet ndërkombëtare.

Si hap i parë, është me rëndësi që institucionet përgjegjëse të punojnë në drejtim të avancimit të kapaciteteve njerëzore, duke siguruar përgatitjen e kuadrove të nevojshme për Sistemin Statistikor të vendit. Në kuadër të këtij procesi është me rëndësi që Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) të ketë mbështetjen e nevojshme për ndërmarrjen e reformave e me theks të veçantë modernizimin e proceseve përmes digjitalizimit. Prandaj, kërkohet koordinim i duhur ndër-institucional në kuadër të përpjekjeve të gjithmbarshme të institucioneve të ndryshme për avancimin e qeverisjes elektronike në administratën publike.

Së dyti, sipas ligjit mbi Statistikat Zyrtare, ASK ka rolin udhëheqës në koordinimin e procesit të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave, ndërsa institucionet dhe agjencitë tjera qeveritare t'i sigurojnë qasje në të dhënat e tyre. Andaj, koordinimi institucional është i nevojshëm për të siguruar zbatimin e dispozitave ligjore, me qëllim të sigurimit me kohë dhe cilësi të të dhënave administrative që mbahen nga institucione të ndryshme. Kjo do të arrihet duke funksionalizuar sistemin e vendosjes së një regjistri bazë (Depo) i cili shërben si një vend (one stop shop) për të gjitha të dhënat statistikore të ASK-së. Përveç qasjes në të dhëna administrative, ASK duhet të rrisë kapacitetet e brendshme të saj për të adresuar mangësitë në mbledhjen, mirëmbajtjen e sigurte dhe përpunimin e mirëfilltë të të dhënave që publikohen nga ASK-ja.

Përmes objektivave të theksuara më lartë synohet të fuqizohet bashkëpunimi ndërkombëtar, përmes nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale dhe avancimit të bashkëpunimit me organizata të ndryshme ndërkombëtare. Duke marr parasysh ndikimin pozitiv nga këto avancime dhe me synim që ASK, të luaj rol pozitiv në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës, është i domosdoshëm ndërmarrja e veprimeve që të promovojë bashkëpunimin e saj në arën ndërkombëtare.

Rritja e numrit të produkteve statistikore dhe frekuencës së tyre, është një objektivë tjetër shumë e rëndësishme e Programit të Statistikave Zyrtare. Në frymë të kësaj, ASK në bashkëpunim me institucionet tjera, synon të rrisë numrin e produkteve statistikore që t'i përgjigjet kërkesave të përdoruesve të brendshëm dhe të jashtëm, dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në avancimin e politikë bërjes. Gjithashtu, synim kryesor është që përmes reformave institucionale, të rritet besueshmëria në të dhënat e Statistikave Zyrtare si dhe fuqizimin e mëtejshëm të SSK.

Aspekt komplementar dhe shumë i rëndësishëm i të gjitha këtyre objektivave është harmonizimi i Sistemit Statistikor me standardet ndërkombëtare. Kosova përmes kësaj synon të jetë pjesë e mekanizmave të ndryshëm ndërkombëtar, të rrisë numrin e klasifikimeve ndërkombëtare të aplikuara dhe numrin e data seteve të harmonizuara dhe të publikuara në Eurostat. Kjo në veçanti do të arrihet përmes fuqizimit të koordinimit me institucionet që janë burim i të dhënave administrative dhe plotësim ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore për zbatimin e klasifikimeve statistikore ndërkombëtare.

2. Hyrje

Bazuar në Ligjin për Statistikat Zyrtare të Kosovës, Programi duhet të sigurojë kornizën për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e Statistikave Zyrtare në Kosovë. Ligji po ashtu përshkruan edhe përmbajtjen e Programit pesë vjeçar të Statistikave Zyrtare (P5SZ-së), kushtet e prodhimit, të mbledhjes së të dhënave, përpunimit dhe shpërndarjes së tyre. Po ashtu, Ligji shpjegon edhe detyrimet për t'i përdorur standardet ndërkombëtare dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, si dhe metodat për shkëmbimin e të dhënave.

Vizioni i Sistemit Statistikor të Kosovës (SSK) është që përmes vendosjes dhe zbatimit të standardeve moderne statistikore që ta ngritë edhe më **shumë besueshmërinë dhe sigurinë e të dhënave statistikore**. Kjo do të arrihet me avancimin e vazhdueshëm të metodologjisë, avancimine proceseve prodhuese statistikore dhe shpërndarjen e Statistikave Zyrtare në përputhje me kërkesat e përdoruesve duke zbatuar kriteret Evropiane.

Misioni i SSK-së është që t'i përmbushë kërkesat e përdoruesve pa dallim, me të dhëna statistikore në aspektin e sasisë, të cilësisë, të besueshmërisë dhe objektivitetit. Të dhënat do të vihen në dispozicion në kohën e duhur me qëllim të lehtësimit të përpjekjeve planifikuese dhe zhvillimore në nivel vendi, komune dhe vendbanimi. Pra, SSK ka për mision t'iu ofrojë informata cilësore statistikore të gjithë përdoruesve, qofshin ata nga institucionet qeveritare, institucionet kërkimore apo akademike, komuniteti ndërkombëtar, komuniteti i biznesit, shoqëria civile dhe publiku i gjerë. Ky sistem duhet t'i përmbushë kërkesat e Ligjit për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Programi i Statistikave ka për fokus dy aspekte të rëndësishme, së pari reformat që duhet të ndërmerren për të fuqizuar SSK dhe së dyti prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare. Qëllimi i këtij programi është avancimi i Sistemit Statistikor të Kosovës në atë mënyrë që i përgjigjet nevojave ekzistuese dhe të ardhshme për të dhëna statistikore.

Gjithashtu, Programi i Statistikave Zyrtare ka për qëllim të adresojë rekomandimet e vlerësimit "Per Review"¹ mbi përputhshmërinë e Sistemit Statistikor me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane², si dhe të gjeturat e Raportit të Vendit të Komisionit Evropian². Kjo do të mundësojë që Kosova të prodhojë statistika me cilësi të mirë në pajtueshmëri me parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane duke u bazuar në pavarësinë profesionale, paanshmërinë, besueshmërinë, transparencën dhe konfidencialitetin.

¹ https://ec.europa.eu/eurostat/documents/45004/9826397/Peer_review_report_KAS_Kosovo_final.pdf/ea9f77cd-30b0-4c38-9e66-09b7a90fc968

² https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report_SQ.pdf

3. Procesi i hartimit të Programit të Statistikave Zyrtare

Ligji për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës paraqet detyrimin që institucionet përgjegjëse për Statistika Zyrtare të hartojnë Projekt Program të Statistikave Zyrtare për miratim në Qeveri dhe shpallje në gazetën zyrtare. Programi hartohet nën udhëheqjen e Agjencisë së Statistikave të Kosovës i bazuar në rekomandimet e Këshillit dhe në konsultim me shfrytëzuesit dhe përdoruesit e Statistikave Zyrtare për një periudhë jo më të shkurtër se pesë vjet, Program i cili duhet të jetë në harmoni me Programin Statistikor të Bashkësisë Evropiane.³

Bazuar në obligimet ligjore, ASK ka iniciuar procesin e hartimit të Programit të Statistikave Zyrtare 2024-2028 në fund të vitit 2022, duke themeluar Grupin Punues sipas rregullativës në fuqi, dhe duke ndjekur të gjithë hapat për hartimin e një programi i cili i përgjigjet kërkesave të shfrytëzuesve të statistikave zyrtare dhe i bazuar në parimet e Programit Statistikor të Bashkimit Europian.

3.1 Metodologjia

Programi i Statistikave Zyrtare 2024-2028 është plani i peste strategjik mbi zhvillimin e SSK. Ky Program është hartuar duke u bazuar në nivelet e zbatimit të planit të fundit strategjik të Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022 dhe synon avancim i të arriturave në kuadër të planit strategjik. ASK, bazuar në mandatin e saj, në baza vjetore ka hartuar raporte të detajuara për zbatimin e Planit Vjetor të ASK-së, plan i cili buron nga programi i Statistikave Zyrtare. Raportet vjetore paraqesin nivelin e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare pesëvjeçar 2018-2022, ku pavarësisht vështirësive që Sistemi i Statistikave është ballafaquar si pasojë e gjendjes me Covid- 19, ka pasur përmirësime substanciale të SSK.

Për më tepër, ASK ka pranuar përkrahje teknike në procesin e hartimit të Programit të Statistikave 2024-2028. Përkrahja teknike e zbatuar nga projekti FCG, e financuar nga Sida Suedeze, duke lehtësuar procesin e hartimit të Programit me punëtori dhe angazhime tjera.

Udhëheqësi i Grupit Punues për hartimin e Programit të Statistikave 2024-2028 ka koordinuar këtë proces me Zyrën për Planifikim Strategjik të Zyrës së Kryeministrit për të vendosur për strukturën e Programit e cila është vendosur që të jetë në linjë me Udhëzimin Administrative 07/2018 për procesin e hartimit të dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit. Kjo strukturë e Programit të Statistikave Zyrtare 2024-2028 ndryshon strukturën e përdorur deri më tani nga ASK, mirëpo nga ana tjetër e harmonizon atë me sistemin e planifikimit strategjik të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ky dokument, bazuar në UA 07/2018, përmban të gjithë kapitujt e nevojshëm sipas udhëzimit. Kakatër (4) Objektiva Strategjike të cilat burojnë nga vlerësimi i gjendjes aktuale në Sistemin e Statistikave të Kosovës. Objektivat Strategjike synojnë që të rrisin efikasitetin e Sistemit Statistikor duke ngritur ASK-në në një institucion efektiv, me resurse të mjaftueshme dhe mirë të trajnuara njerëzore, të cilat kanë në përdorim infrastrukturë teknologjike të avancuar për prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve statistikore. Po ashtu Objektivat Strategjike synojnë të vendosin një koordinim dhe bashkërendim si brenda ASK e ashtu edhe me institucionet të cilat janë burimi të dhënave administrative në mënyrë që të rritet numri dhe frekuenca e produkteve statistikore, të cilat janë në linjë me standardet më të mira ndërkombëtare.

³ Shih nenet 13 dhe 14 të Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës në: [Datë: 02 \(rks-gov.net\)](https://rks-gov.net)

4. Analizë e situatës /Gjendja/

Analiza e situatës është e bazuar në të gjeturat e raportit për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022 dhe mbulon fushat të cilat kanë qenë pjesë e atij Programi, si dhe fushat që dotë shtohen në Programin aktual.

Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2023 për Kosovën, thekson se Kosova ka arritur një nivel të përgatitjes në fushën e statistikave. Është arritur progres veçanërisht në përmirësimin e metodologjisë së mbledhjes së të dhënave dhe transmetimit të tyre në Eurostat. Gjithashtu, raporti thekson se ASK duhet të shtojë përpjekjet për adresimin e rekomandimeve të “Peer Review” nga Eurostat. Të rrisë numrin e produkteve statistikore si dhe të rrisë numrin e kapaciteteve njerëzore fillimisht duke plotësuar pozitat e mbetura të zbrazëta. Sfidë mbetet gjithashtu, koordinimi në nivel teknik ndërmjet institucioneve statistikore, si dhe përdorimi i të dhënave administrative në dispozicion mbetet i pamjaftueshëm. Duhet gjithashtu të përmirësohet përafrimi i statistikave sektoriale me standardet evropiane si dhe të sigurohen ofrimi i produkteve të reja statistikore.

Për infrastrukturën statistikore, kuadri ligjor është gjerësisht në përputhje me Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane. Megjithatë, zbatimi i tij duhet të bëhet duke ruajtur rolin udhëheqës të ASK-së, duke përmirësuar qeverisjen statistikore dhe koordinimin ndërmjet institucioneve kryesore statistikore, sigurimin e qasjes më të mirë në burimet e të dhënave administrative, dhe metodologji e integruar e aktiviteteve të ASK në prodhimin e Statistikave Zyrtare. Agjencia duhet të intensifikojë zbatimin e rekomandimeve të vlerësimit nga procesi “Per Review” eksperteve të Eurostat-it, veçanërisht duke rritur kosto-efektivitetin e tij, duke forcuar menaxhimin e cilësisë dhëmarrëdhëniet me përdoruesit e të dhënave.⁵

4.1 Qasja institucionale

Zhvillimi, zbatimi dhe raportimi i Programit të Statistikave Zyrtare të Kosovës përcaktohet në masë të madhe nga procesi i zhvillimit institucional të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK).

ASK, është institucioni kryesor për hartimin, menaxhimin dhe publikimin e të dhënave statistikore në Republikën e Kosovës.⁶ ASK ka vazhduar me rritjen e numrit të produkteve të Statistikave Zyrtare si dhe në uljen e numrit të ditëve në dispozicion për prodhimin e Statistikave Zyrtare. Kjo është reflektuar me theks në Statistikat Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare, si dhe në Statistikat Sociale ku kemi rritje të efikasitetit të prodhimit të këtyre statistikave nga viti 2012 (ditë punë për produkt dhe koha prodhuese janë shkurtuar). Zbatimi i Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022 është arritur në masë të madhe (shih tabelën më poshtë).

Përmbledhje ekzekutive, 2021-2022 dhe objektivi 2024-2028

Statusi	Gjendja 2022	54 Produkte krahasuese		Ndryshimi	Plan	Objektivi 2028	% (+/-)
Përshkrimi	1	2			3	4	5
Treguesit/Vitet		2021	2022	(+/-) %	2024	2028	
T1.Produkte statistikore	76	63	76	20.6%	82	91	20%
T1a.Publikime Statistikore	172	121	172	42%	186	206	20%
T4.Dite pune për produkt (total)	5937	5284	5303	+0.3%	5700	5343	-10%
T4a.Dite pune për produkt (mes.)	78	97.8	98.2	+0.4%	74	70	
T5.Koha prodhuese (total)	15221	12537	10214	-18.5%	14612	13699	-10%
T5a.Koha prodhuese (mesatarisht)	200	232	189	-18.5%	192	1180	
T6.Norma e publikimeve në kohë (%)	92	115/121	159/1172	60/99	186/186	206/206	100%
Në nivel të ASK-së, në %		95	92	39	100	100%	

Pavarësisht të arriturve të ASK në vitet e fundit dhe nivelit të zbatimit të Programit 2018-2022, ASK ballafaqohet me vështirësi të shumta në zbatimin e mandatit të saj. Këto vështirësi janë në thelb strukturore, dhe vijnë si pasojë e ndarjeve buxhetore, personelit, qasja e integruar institucionale e ASK, nivelit të bashkërendimit me institucione tjera prodhuese të statistikave zyrtare, bashkëpunimit dhe subjektivitetit të saj ndërkombëtar.

A) Buxheti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës

Buxheti i ASK që nga viti 2019 ka pësuar ndryshime nga viti në vit, tek zërat buxhetor të mallrave dhe shërbimeve, ndërsa tek pjesa e pagave dhe shtesave si dhe shpenzimeve komunale nuk ka pasur ndryshime substanciale. Mirëpo ndryshimet substanciale të reflektuara në mallra dhe shërbime kanë ndikuar në buxhetin total të ASK ndër vite.

Siç mund të shihet nga tabela më poshtë, buxheti i ASK për mallra dhe shërbime në vitin 2020 ka qenë mbi 1.6 milion Euro, buxhet i cili në vitet në vijim duhet të rritet në përputhje me nevojat e ASK-së, për rritjen e aktiviteteve të reja hulumtuese e cila si rrjedhojë kërkon rritjen e numrit të stafit të saj. Kjo në masë të madhe ka të bëjë me produktet statistikore të realizuara dhe planifikuara, ku në vitin 2020 kanë qenë 63 produkte me 121 publikime statistikore, ndërsa në vitin 2023, janë realizuar 82 produkte dhe 213 publikime statistikore. Po ashtu në vitin 2025 planifikohet të bëhet Regjistrimi i bujqësisë së Kosovës.

Një pasqyre e buxhetit sipas kategorive ekonomike është dhënë si në tabele:

Tab. 1: Buxheti 2023-2024, plani 2025

Përshkrimi	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Paga e mëditje	1,058,208.84	1,221,776.80	1,480,789.45
Mallra dhe shërbime	10,466,356.00	8,123,517.00	2,348,413.55
Komunale	21,875.00	21,875.00	33,500.00
Gjithsej	11,546,439.84	9,787,167.80	4,362,703.00

Burimi: SIMRF/ASK

Për vitin 2024 përveç aktiviteteve të rregullta të ASK-së është përfshirë edhe buxheti për Regjistrim të Popullsisë në të gjitha kategoritë ekonomike.

Sipas KASH-it 2025-2027, në vitin 2025 në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime përveç aktiviteteve të rregullta të ASK-së është ndarë buxhet për fazën finale të Regjistrimit të Popullsisë si dhe për përgatitjet e Regjistrimit të Bujqësisë.

B) Personeli i Agjencisë së Statistikave të Kosovës

Agjencia e Statistikave të Kosovës që nga viti 20219 ka mjete të buxhet-ura për 166 punëtorë të saj. Nga viti 2020, si rezultat i ndryshimeve ligjore të ligjit të shërbyesve civil, ASK nuk ka mundur të mbajë numrin e punëtorëve sipas ndarjeve buxhetore. Me ndryshimet legjislative që janë bërë në vitin 2023, të ligjit të zyrtarëve publik, ASK, ka mundësi për plotësimin e pozitave të lira të planifikuara më buxhet.

Gjatë periudhës 2024-2028, ASK planifikon zgjerimin e hulumtimeve të reja Statistike si dhe kalimin e publikimeve me frekuencë më shumë se një herë në vit. Andaj për të plotësuar nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kërkohet rritja e numrit të stafit aktual.

Tab. 2: Stafi ASK-se ndër vite

Viti	2023	2024	2025	2026	2027	2028 Plani
Të buxhetuar	166	166	166	166	166	166
Aktual (efektiv) ⁴	137	129	129	149	179	223
Të nevojshëm	176	186	196	206	216	223

Personeli i ASK ka nevojë për trajnime profesionale në fusha të ndryshme siç janë përdorimi i Teknologjisë së Informimit (TI), programe të ndryshme statistikore, standarde të ndryshme, etj.

⁴ Në vitet 2023 dhe 2024 gjendja reale e stafit në ASK, ndërsa për vitet 2025-2028 një Planifikim për rekrutimin e tyre nëse parapakisht nga Qeveria me ligjin mbi ndarjet buxhetore aprovohen pozita të reja për ASK.

C) Qasja e integruar e Agjencisë së Statistikave të Kosovës

Agjencia e Statistikave të Kosovës në kuadër të mandatit të saj ndërmerr veprime për prodhimin e Statistikave Sektoriale si: Llogaritë Kombëtare, Statistikat Ekonomike, Statistikat Sociale, Popullsisë, Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit etj. Veprimet e Departamenteve të ASK nuk janë të ndërlidhura, në një data bazë të centralizuar të statistikave. Në përgjithësi bashkëpunimi në mes të departamenteve dhe brenda departamenteve është i bazuar në shpërndarjen e të dhënave në bazë të kërkesave të ndërsjella.

ASK, ka Kalendarin e Publikimeve vjetore të Statistikave, i njëjti mund të rishikohet në mënyrë që të jetë Kalendar i harmonizuar me frekuencën, rëndësinë, kapacitetet në dispozicion dhe nevojën për produktet statistikore.

D) Bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare

Agjencia e Statistikave të Kosovës, në procesin e prodhimit të Statistikave Zyrtare duhet të bashkëpunojë me institucione relevante që janë burim i të dhënave administrative. Një proces i tillë është pjesë edhe e Kodit të Praktikës së BE i cili kërkon që shtetet të kenë të rregulluar që autoritetet e Statistikave Zyrtare të kenë qasje të pa penguar dhe bashkëpunim nga institucionet relevante, që janë burim i të dhënave administrative.

Baza Ligjore ekziston për këtë çështje, që i garanton qasje të pandërprerë ASK-së në këto të dhëna për prodhimin e statistikave, por një gjë e tillë duket të jetë më e vështirë në praktikë sesa në dukje. ASK ka nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi (MeM) me disa institucione, por në të shumtën e rasteve ose ekziston mungesë e infrastrukturës për qasje në këto të dhëna, ose nën pretekstin e mbrojtjes së të dhënave zyrtare/mbrojtës së konfidencialitetit, etj. vështirësohet kjo qasje për personelin e ASK-së.

Prandaj përmes (MeM) me institucionet tjera, ASK në vitet e fundit lehtësoi qasjen e saj në burimet administrative për të dhëna, të cilat janë shumë të nevojshme për prodhimin e Statistikave Zyrtare në fusha të ndryshme përkritazi me legjislacionin në fuqi dhe parimin e Kodit të Praktikës së Bashkimit Evropian. Kjo ka bërë të mundur rritjen e efikasitetit në mbledhjen e të dhënave, në cilësinë në prodhimin e statistikave zyrtare të Republikës së Kosovës dhe krahasueshmërinë me statistikatat e vendeve tjera të rajonit dhe më gjerë.

Që nga viti 2006 e deri më tani, ASK ka nënshkruar marrëveshje me institucione vendore, në mënyrë që të ketë qasje të pandërprerë në të dhëna administrative.

Tab. 3: Memorandume të Mirëkuptimit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës me Institucionet për qasje në të dhëna administrative

	INSTITUCIONI	DATA	FUSHA/QASJA
1	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	2006	
2	Banka Qendrore e Kosovës	2006	Qasje në të dhëna të BQK përkritazi me legjislacionin në fuqi, shkëmbim të përvojave në inventarizimin e të dhënave, dhe përcaktimi i pikave të kontaktit. Duhet të rishikohet përkritazi merrtjen e përgjegjësisë të BQK
3	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	2006	

4	Ministria e Shëndetësisë	2006	Pjesë e MM me Ministrisë së MPH, MBPZHR, dhe Zyrës Rregullative për Ujëra dhe Mbeturina; Përcakton lëmit e bashkëpunimit, përgjegjësitë institucionale, fushatë shkëmbimit të informatave dhe afatet kohore; Fokus i limituar i MeM vetëm IKSH
5	Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit	2006	
6	Ministria e Transportit dhe Komunikimit(MMPHI)	2009	Qasje në të dhëna e departamenteve të ndryshme të MMPHI përkitazi me legjislacionin në fuqi, fokusi i përdorimit të dhënave, citimi i tyre, shkëmbim të përvojave, dhe përcaktimi i pikave të kontaktit. Ngjashëm edhe me ish Ministrinë e Mjedisit, sipas pikave më lartë që është e aplikueshme tani si institucion i fuzionuar.
7	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPHI)	2009	Qasje në të dhëna të fokusuara vetëmnë regjistrin e komunave, vendbanimeve, dhe rrugëve për vendbanimet urbane.
8	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	2009	
9	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	2009	Qasje në të dhëna të fokusuara vetëmnë Departamentet e Sportit dhe Kulturës, fokusi i përdorimit të dhënave, citimi i tyre, shkëmbim të përvojave, dhe përcaktimi i pikave të kontaktit.
10	Ministria e Zhvillimit Ekonomik (ME)	2013	
11	Administrata Tatimore e Kosovës	2014	
12	Agjencia Kosovare e Privatizimit	2014	
13	Radio Televizioni i Kosovës	2014	
14	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	2015	
15	Policia e Kosovës	2016	
16	Agjencia e Regjistrimit Civil	2017	Qasje në të dhëna të ARC përkitazi me legjislacionin në fuqi, shkëmbim të përvojave në inventarizimin e të dhënave, dhe përcaktimi i pikave të kontaktit.
17	Universiteti Hasan Prishtina	2018	
18	INSTAT (Shqipëri)	2020	
19	Zyrën Statistikore të Maqedonisë	2021	
20	SIDA Suedeze	2021	
21	Agjencia e Regjistrimit Civil	2022	Marrëveshje mbi përpunimin e të dhënave personale për Regjistrin Statistikor të Popullsisë.
22	Zyrën Çeke të Statistikave	2023	

Me qëllim të qasjes më të madhe në të dhëna administrative, ASK, duhet të rrisë bashkëpunimin me institucione tjera. Përveç Marrëveshjeve, ASK ka luajtur rol substancial në bashkërendimin me institucione tjera në zbatimin e obligimeve shtetërore, agjendës evropiane, dhe planifikimeve qeveritare përkitazi me rolin dhe mandatin e saj.

ASK në zbatim të Programit të Statistikave Zyrtare, synon që të rrisë bashkëpunimin me institucione vendore dhe ndërkombëtare. Në kuadër të institucioneve vendore, ASK synon që të ketë bashkëpunim me të gjitha ato institucione që janë burim i të dhënave për prodhimin e Statistikave Zyrtare. Ndërsa, në arenën ndërkombëtare, ASK do të jetë promotor e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës në përgjithësi, dhe ASK në veçanti përkitazi me programin e Qeverisë dhe synimeve nacionale.

E) Mbështetja e ASK nga donatorë të jashtëm

Mbështetja dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e Statistikave Zyrtare vazhdon të jetë gjithëpërfshirës, duke mbuluar pothuajse të gjitha fushat e Statistikave Sektoriale dhe më gjerë (ndërtimi i kapaciteteve përmes Projekteve Pilot, trajnime, IT).

Rritja e prodhimit statistikor dhe përmirësimi i cilësisë së Statistikave Zyrtare është një nga objektivat kryesore të ASK-së, të cilat gjithashtu përkojnë me strategjinë e programit shumë përfitues të Komisionit Evropian, përkatësisht Eurostat për rritjen e përputhshmërisë së Statistikave Zyrtare me ACQUIS. Përveç Komisionit Evropian, ASK-ja mbështetet edhe nga FMN, BB, Sida Suedeze, Swiss Contact, GIZ- Gjerman, Organizatat e Kombeve të Bashkuara, etj.

Në nivel operacional, zbatimi dhe përafrimi i metodologjive me standardet ndërkombëtare në nxjerrjen e Statistikave Zyrtare në kuadër të Sistemit Statistikor të Kosovës paraqet boshtin e bashkëpunimi ndërmjet ASK-së dhe institucioneve ndërkombëtare, me theks të veçantë në Eurostat.

F) Mekanizmat mbikëqyrës

Agjencia e Statistikave të Kosovës - është institucion i pavarur përkitazi me rregullat ivën në fuqinë kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Raporti vjetor i punës, dërgohet nga Qeveria e Kosovës në Kuvendin e Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe aprovim.

Synimi i Kosovës në aspektin afatgjatë është anëtarësimi në mekanizmat ndërkombëtar. Çdo institucion luan rolin e saj në procesin e integrimi Evropiane, prandaj edhe ASK është e angazhuar në avancimin e Kosovës në procesin e Integrimi Evropiane, së pari duke zbatuar kriteret e parapara në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane, si dhe me të dhëna Statistike Zyrtare me cilësi dhe kualitet të lartë.

Vëmendje e veçantë i jepet raportit të “Peer Review” të vitit 2017, ku sipas vlerësimeve të Raporteve Vjetore, zbatimi i tij ka arritur në nivel të 85.7%. Këto rekomandime janë të përmblëdhura në kornizën e konsolidimit institucional, rritjen e burimeve dhe zbatimin e kost- efektivitetit, zhvillimin e Menaxhimit të Cilësisë dhe Metodologjisë, si dhe fuqizimin e marrëdhënieve me Përdorues. Duke marr parasysh faktin që vlerësimi i quajtur “Peer Review” organizohet në një interval 7-8 vite, ASK duhet të rrisë masën e zbatimit të rekomandimeve në mënyrë që të avancohet Sistemi i Statistikave të Kosovës në zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare, me theks në praktikat Evropiane.

Si mekanizëm i veçantë konsultativ dhe këshillëdhënës është edhe Këshilli i Statistikave të Kosovës. ASK do të vazhdojë të jetë forum i diskutimeve të këtij Programi, planeve të saj, rekomandimeve të dala nga “Peer Review”, dhe rekomandimeve të Këshillit të Statistikave në vazhdimësi. Përveç Agjencisë së Statistikave, bartësit e statistikave janë gjithashtu Banka Qendrore dhe Ministria përgjegjëse për Financa.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - Në bazë të nenit 25 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, BQK për përmbushjen e objektivave të saj mbledh, përpilon dhe publikon statistika dhe informacione tjera të nevojshme. Mbledhja e të dhënave statistikore bëhet për të nxitur dhe mbajtur një sistem financiar stabil; sistem të pagesave efikase dhe të sigurta; për të kontribuar në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore; për të mbështetur politikate përgjithshme ekonomike të Qeverisë; për të informuar Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe publikun e gjerë për treguesit real të ekonomisë, për raportim në organizatat ndërkombëtare, si dhe për realizimin e proceseve dhe politikave nga vet BQK-ja.

Përpilimi dhe publikimi i statistikave bëhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare dhe në praktikën më të mirë të vendeve të tjera. Në mënyrë që të avancohet më tepër Sistemi i Statistikave Zyrtar, BQK synon të zgjerojë numrin e publikimeve të statistikave monetare dhe financiare dhe të rrisë nivelin e harmonizimit të statistikave të sektorit monetar dhe financiar me kërkesat e Bankës Qendrore Evropiane.

Për të kontribuar më efektivitet në vizionin brenda Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare, dhe bazuar në gjendjen aktuale, BQK ka identifikuar këto prioritetet strategjike për të udhëhequr punën tonë gjatë pesë viteve të ardhshme. Prioritetet strategjike janë:

- a) Rritja e volumit të prodhimeve statistikore, përmirësimi i periodicitetit dhe frekuencës së publikimit;
- b) Rritja e nivelit të harmonizimit të statistikave kombëtare me standardet e BE-së dhe
- c) Konsolidimi i statistikave gjithëpërfshirëse të llogarive financiare.

Ministria për Financa, Punë dhe Transfere - Ministria përgjegjëse për Financa, është përgjegjëse të bëjë parashikime dhe analiza për të mbështetur procesin e vendimmarrjes, lidhur me formulimin e politikave ekonomike. Një nga detyrat e rëndësishme të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është përgatitja e buxhetit të shtetit, menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore. Objektivi kryesor është përgatitja e analizave më të besueshme mbi zhvillimet aktuale ekonomik dhe dhënia e këshillave me kohë ndaj goditjeve të mundshme, me të cilat mund të përballët ekonomia e Kosovës.

Ofrues të tjerë të të dhënave, që përdoren për prodhimin e Statistikave Zyrtare në Kosovë, janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit e cila mbledhë dhe përpunon të dhëna për numrin e shkollave, nxënësve dhe personelit arsimor në arsimin para universitar,

Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik janë përgjegjës për regjistrimin e numrit të institucioneve shëndetësore, pacientëve, mjekëve dhe sëmundjeve. Ministria e Punës së Brendshme është përgjegjëse për të dhënat e emigracionit etj. Megjithatë, ofrues tjetër i Statistikave Zyrtare mund të jetë vetëm institucioni, i cili merr autorizimin nga ASK-ja për plotësimin e kriterëve për prodhimin e Statistikave Zyrtare.

4.2 Zhvillimi i politikave i bazuar në të dhëna

Sistemi statistikor është shumë i rëndësishëm për planifikimin dhe monitorimin e politikave, prandaj si përdorues të rëndësishëm, avancimi i mëtutjeshëm i Statistikave Zyrtare, do të mundësojë një planifikim të bazuar në të dhëna. Gjithashtu, kjo do të mundësojë përcaktimin e treguesve kombëtar për matjen e progresit në nivel të vendit dhe ndërlidhjen e tyre me Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Kosova ka hartuar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, për monitorimin dhe vlerësimin e suksesshëm të saj. Mbledhja e të dhënave duhet të përmirësohet në të gjithë sektorët dhe nivelet. Në mënyrë që monitorimi i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit (SKZH) dhe strategjive të tjera sektoriale të bëhet në kohë reale,

publikimi i të dhënave në periudhat e parapara është po ashtu kyç. Në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të aspektit gjithëpërfshirës të strategjisë, e rëndësishë së veçantë janë po ashtu zbërthimi i të dhënave sipas vendbanimit, gjinisë, etnisë, moshës, aftësive të kufizuara.

Organet dhe Institucionet përgjegjëse për mbledhjen, analizimin, dhe publikimin e të dhënave në nivel të vendit duhet të jenë pjesë kyçe e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë, në mënyrë që të mundësohet përdorimi i të dhënave dhe tejkalimi i boshllëkut të monitorimit. Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave të caktuara, gjatë zhvillimit të strategjisë janë identifikuar edhe tregues specifik të cilët duhet të përfshihen në proceset aktuale të mbledhjes së të dhënave, si dhe janë propozuar instrumente të cilat do të përmirësojnë dukshëm bazën e të dhënave për monitorimin e SKZH, por edhe do të shërbejnë për zhvillimin e politikave tjera bazuar në evidencë dhe të dhëna.

A) Efikasiteti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës

Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2013 ka pasur 40 produkte statistikore dhe 93 publikime. Në fund të vitit 2023 ky numër është rritur në 82 produkte statistikore dhe 213 publikime. Gjatë kësaj periudhe ASK ka pasur një rritje prej mbi 105% në produkte statistikore dhe rreth 129 % në publikime statistikore.

Agjencia e Statistikave të Kosovës, është Institucioni përgjegjës me Ligj që të mbledhë, përpunojë dhe publikojë Statistikat Zyrtare duke u zbatuar në Standardet e Eurostat-it të specifikuara në Kodin e Praktikës. Objektiva e ASK-së në Programin e Statistikave Zyrtare 2018-2022 ishte zgjerimi, përmirësimi i kualitetit si dhe shkurtimi i afateve kohore, me synim të përmbushjes së nevojave të shfrytëzuesve me të dhëna statistikore sipas standardeve të BE-së. Raportet e publikuara vlerësuese për ASK-në nga Komisioni Evropian, përfshirë edhe Eurostat-in dhe organizata tjera ndërkombëtare, që rekomandojnë rritjen e sasisë dhe cilësisë së prodhimeve statistikore.

ASK, duhet të vazhdojë rritjen e produkteve të saj statistikore, shkurtimin e afateve kohore si dhe rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së produkteve statistikore. Në bazë të Planit të saj të Prodhimit të Statistikave, ASK deri më tani ka ofrua Statistika Zyrtare të fushave të ndryshme sektoriale me frekuencë të publikimit në baza mujore, tremujore, vjetore, dy vjetore si dhe në raste të rralla në baza 4 vjeçare.

Statistikat Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare janë statistikat kyçe që ASK prodhon dhe publikon në baza mujore, 3 mujore dhe vjetore. Mbledhja, përpunimi, dhe publikimi i këtyre statistikave bëhet në pajtim me Sistemin Evropian të Llogarive. Lista e produkteve të ASK për vitin 2023 është baza e produkteve të Programit të Statistikave Zyrtare 2024-2028. Ndërsa, në vitet e ardhshme ASK, përveç listës së produkteve të planit 2023, do të përfshijë edhe produktet si vijon:

Tab. 4. Plani për zgjerimin e Statistikave për vitet 2024-2028

Institucioni bartës	Aktivitetet	Periudha kohore	Buxheti
ASK	Realizimi i Regjistrimit të Popullsisë 2024	Prill-Maj 2024	BRK/Donator
ASK	Publikimi i rezultateve 2024/2025	Dhjetor 2024/2025	BRK/Donator
ASK	Përpilimi i Llogarive Sektoriale jo inanciare	Dhjetor 2024	BRK/Donator

ASK	Tabelat ofruese-përdoruese(SUT)	Dhjetor 2024	BRK
ASK	Tabelat hyrëse-dalese (IOT)	Dhjetor 2024	BRK
ASK	BPV me qasjen e të ardhurave	Shtator/2025	BRK
ASK	Përpilimi i Llogarive Regjionale	Tetor /2025	BRK
ASK	BPV me PPP	Dhjetor /2027	BRK
ASK	Integrimi në BPV i të dhënave të ekonomisë joformale bazuar në kontrollet e auditimit fiskal	2025	BRK
ASK	Integrimi në BPV i të dhënave të ekonomisë joformale bazuar në Metodën e Inputit të Punës	2025	BRK
ASK	Integrimi në BPV i të dhënave të ekonomisë joformale për sektorin e shëndetësisë	2025	BRK
ASK	Integrimi në BPV i të dhënave të ekonomisë joformale për aktivitetet ilegale – trafikimin e drogës	2025	BRK
ASK	Integrimi në BPV i të dhënave të ekonomisë joformale për llojin N1 dhe N6 - keq raportimin e personave të vetëpunësuar	2025	BRK
ASK	Indeksi i çmimeve të prodhimit, ICI në baza mujore	2026	BRK
ASK-BQK-MFPT	Indeksi çmimeve të pasurisë së paluajtshme	2025	BRK
ASK	Pariteti i Fuqisë blerëse	2025	BRK
ASK	Publikimi i rezultateve të Anketës së të ardhurave nga puna	2025	BRK
ASK	Shtimi i ad-hoc moduleve të AFP-së çdo vit	2025	BRK
ASK	Publikimi i rezultateve të anketës së arsimimit të të rriturve	2025	BRK
ASK	Publikimi i Rezultateve të anketës së vendeve të lira të punës në baza tremujore	2025	BRK

ASK	Indeksi i kostos së punës	2026	BRK
ASK	Realizimi i Anketës së trajnimit profesional të vazhdueshëm	2026	BRK
ASK	Prodhimi i treguesve të mbrojtjes sociale në përputhje me Sistemin e Integruar Evropian të Mbrojtjes Sociale (ESSPROS)	2028	BRK
ASK	Parapërgatitjet për ReB (Metodologjia, Pyetësorët, Udhëzuesit dhe Testimi)	2024/2025	BRK
	Realizimi i RB (mbledhja e të dhënave nga terreni)	2025/2026	BRK
	Publikimi i të dhënave të RB	2026/2027	BRK
ASK	Anketa mbi prodhimin e qumështit	2024-2028	BRK
ASK	Anketa mbi therjet e kafshëve	2024-2028	BRK
ASK	Prodhimi i statistikave tëpylltarisë	2024-2028	BRK
ASK	Anketa e Kulturave Bujqësore Bimore	2024 -2028	BRK

➤ **Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave**

Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave është realizuar 05 Prill-17 Maj 2024. Të dhënat paraprake do të publikohen brenda tre muajve pas përfundimit të Regjistrimit të Popullsisë, ndërsa të dhënat e para finale do të publikohen brenda 9 muajve pas përfundimit të Regjistrimit. Të dhënat nga ky Regjistrim do të shërbej si bazë për mirëmbajtjen e Regjistrit Statistikor të Popullsisë dhe Kornizat e Mostrës për Anketa.

➤ **Regjistrimi i Bujqësisë**

Regjistrimi i Bujqësisë sipas Standardeve Ndërkombëtare (FAO; Eurostat) duhet të kryhet në çdo 10 vjet. Kosova e ka realizuar Regjistrimin e Bujqësisë të fundit në vitin 2014 (pas 54 viteve). Aktualisht Agjencia e Statistikave të Kosovës po planifikon ta realizojë Regjistrim e Bujqësisë në tërë territorin e Republikës së Kosovës në vitin 2025/2026. Të dhënat e Regjistrimit të Bujqësisë përmirësojnë dhe forcojnë Sistemin Statistikor të Kosovës lidhur me disponueshmërinë, cilësinë, krahasueshmërinë e të dhënave statistikore dhe të siguroj të dhëna më të freskëta lidhur me sektorin bujqësor. Kjo i ndihmon vendimmarrëseve si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, në planifikimin e politikave bujqësore si dhe ju ndihmon të gjithë shfrytëzuesve tjerë .

➤ **Statistikat Sociale dhe të Popullsisë**

Në fushën e Statistikave Sociale dhe të Popullsisë, Statistikat Demografike përputhen kryesisht me ACQUIS të BE-së, gjegjësisht Kornizën Ligjore dhe Metodologjike të BE-së si dhe parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane. Përgatitjet për publikimin e rezultateve të Regjistrimit të Popullsisë vazhdojnë, në përputhje me Ligjin për Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave të ratifikuar dhe dinamiken e ASK-së.

Statistikat mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (Anketa e rregullt e BE-SAKJ) nga viti 2018 publikohen çdo vit, ku të dhënat e fundit të publikuara janë të vitit 2022, derisa ato të vitit 2023 janë në përpunim. Megjithatë, ASK përballet me sfida në lidhje me analizën dhe përfundimin e kësaj ankete të rëndësishme për shkak të stafit të kufizuar. Synohet prodhimi i më shumë treguesve nga anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (SILC).

Statistikat e Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit në Ekonomi Familjare (TIK) janë në harmoni të plotë me standardet e Eurostat-it.

Statistikat e Kulturës - është bërë një progres tek Statistikat e Kulturës ku për herë të parë në publikimin vjetor "Statistikat e Kulturës 2022", janë përfshirë tregues të rinj nga anketat që ASK i zhvillon dhe do të vazhdohet me rritjen e numrit të treguesve të publikuar duke shfrytëzuar burimet nga anketat dhe të dhënat administrative

Statistikat e Tregut të Punës publikohen vetëm pjesërisht. Anketa e Fuqisë Punëtore është anketë e vazhdueshme dhe kryhet rregullisht dhe afati kohor i publikimit është përmirësuar, (çdo tre muaj). Nga viti 2025 planifikohet zbatimi i rregullores së re të statistikave evropiane për punësimin dhe papunësinë (2019/1700) pritet nga vitit

Për herë të parë është zhvilluar Anketa e Kostos së Punës rezultatet e së cilës janë publikuar në vitin 2023. Kjo anketë do të vazhdojë si anketë e rregullt me periodicitet 4 vjeçar. Anketa e strukturës së të ardhurave nga puna do të zhvillohet gjatë vitit 2024. Anketa mbi Vendet e Lira të Punës planifikohet që të zhvillohet si anketë e rregullt tremujore nga viti 2025.

Sa i përket Statistikave të Arsimit, është bërë progres drejt prodhimit të tyre sipas standardeve ndërkombëtare të klasifikimit të arsimit (ISCED 2011 dhe ISCED F 2013 Deri më tani statistikave të arsimit janë publikuar duke shfrytëzuar vetëm burimet administrative të të dhënave. Gjatë vitit 2024 do të zhvillohet për herë të parë Anketa për arsimimin e të rriturve. Ndërsa anketa për trajnimin profesional të vazhdueshëm planifikohet që të zhvillohet në vitin 2026.

Statistikat e Mirëqenjes Sociale - janë zhvilluar disa aktivitete sa i përket zbatimit të sistemit të Integruar të mbrojtjes sociale (ESSPROS), është përgatitur lista e klasifikimeve të skemave të ESSPROS dhe i përfitimeve sociale, është plotësuar pyetësi me të dhëna cilësore si dhe plotësimi i modulit për përfituesit e pensioneve dhe janë transmetuar në Eurostat;

Statistikat e Shëndetësisë - ende nuk janë në përputhje me standardet e BE-së. Synohet përmirësimi i cilësisë së të dhënave dhe prodhimi i treguesve të shëndetësisë duke përfshirë të dhënat nga anketat si dhe të dhënat nga sektori privat.

Statistikat e Drejtësisë dhe Krimeve - nuk janë ende në përputhje me standardet e Eurostat-it. Synohet prodhimi i treguesve cilësor dhe të krahasueshëm në fushën e drejtësisë dhe krimit në harmoni me standardet e Eurostat-it.

➤ **Llogaritë kombëtare**

Në lidhje me Statistikat Makroekonomike, vlerësohet se janë bërë përmirësime të dukshme. Agjencia E Statistikave të Kosovës përpilon Llogaritë Kombëtare vjetore dhe tremujore përfshirë ato sipas përshtatjeve sezonale dhe lidhjeve zinxhirore, megjithatë, akoma nuk janë në harmoni të plotë me ESA2010. Janë bërë përmirësime të dukshme në këtë periudhë, si shkurtimi i afatit të publikimit të Llogarive Kombëtare tremujore në T+75 ditë në harmoni me Standardet Evropiane, për llogaritja e BPV-së sipas Qasjes së të Ardhurave (për 2011-2019) si eksperimentale, Përpilimi i Llogarive Sektoriale Jo-Financiare (2016-2019) dhe Tabelat e Furnizimit dhe Përdorimit (SUT; 2013-2015), përpilimi i Llogarive Rajonale (eksperimentale 2018 dhe 2019).

Progres është arritur edhe në fushën e Ekonomisë Joformale, ku të dhënat e Ekonomisë Joformale janë integruar për herë të parë në të dhënat e PBV-së për Aktivitetet Ekonomike: 49-Transporti tokësor, 55-Akomodimi dhe 56-Aktivitetet e shërbimit të ushqimit dhe pijeve, si rezultatet e projektit të financuar nga Banka Botërore. Po ashtu, ASK ka zbatuar metodologjinë e Eurostatit për komponentët në vijim: vlerësimi i Ekonomisë Joformale në bazë të auditimit fiskal, vlerësimi i Ekonomisë Joformale në bazë të Metodës së Inputit të Punës (LIM), vlerësimi i aktiviteteve ilegale – trafikimi i drogës dhe vlerësimi i llojit N1 dhe N6 – keq raportimi i numrit të të vetë punësuarve. Numri i tabelave sipas ESA 2010 të transmetuara në Eurostat, është rritë shumë gjatë periudhës raportuese. ASK-ja ka vazhduar të dërgojë disa tabela të PZHQ-së brenda afateve të kërkuara por ato nuk janë plotësisht në përputhje. Statistikat mujore për Tregtinë Ndërkombëtare të Mallrave dorëzohen në Eurostat. Të dhënat e Bilancit të Pagesave përpilohen nga Banka Qendrore dhe janë përgjithësisht në përputhje me ACQUIS të BE-së; të dhënat vjetore dhe tremujore i dorëzohen Eurostat-it. Statistikat e Financave të Qeverisë në harmoni me ESA2010 publikohen në baza tremujore dhe vjetore nga ASK-ja. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit publikohet rregullisht në ueb faqen e ASK-së dhe transmetohet në Eurostat ku publikimi është planifikuar për më vonë gjatë këtij viti. Ai po zhvillohet më tej në përputhje me standardet e BE-së (klasifikimi ECOICOP). Nuk është arritur progres në zgjerimin e punës lidhur mes Paritetin e Fuqisë Blerëse (PFB).

➤ Statistikat ekonomike

Statistikat e Tregtisë se Jashtme janë plotësisht të harmonizuara me ACQUIS të BE-së. Statistikat e Energjisë rreth 90% janë të harmonizuara, po ashtu edhe Statistikat e Hotelërisë dhe Turizmit si dhe Statistikat e Transportit. Te gjitha këto raportohen edhe në Eurostat.

Statistikat Strukturore të Biznesit, Statistikat e Investimeve dhe disa Statistika Afatshkurtra (SASH) janë pjesërisht në përputhje me ACQUIS të BE-së. Statistikat e Industrisë, Shërbimeve, Tregtisë me Pakice, hotelërisë dhe Energjisë nga viti 2022, kanë kaluar në publikime në baza mujore.

Statistikat e Industrisë (anketimi PRODCOM) për vitin 2022 u publikuan në dhjetor të vitit 2023. Statistikat e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK) për Ndërmarrjet janë mbledhur për vitin referues 2022, rezultatet janë publikuar në dhjetor të vitit 2023.

Sa i përket Çmimeve, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit publikohet rregullisht në ueb faqen e ASK-së në baza mujore dhe transmetohet në Eurostat. Ai po zhvillohet më tej në përputhje me standardet e BE-së (klasifikimi COICOP), ndërsa Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇI), Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) dhe Indeksi i Kostos së Ndërtimit ende nuk raportohen në Eurostat.

➤ Statistikat e Bujqësisë

Për Statistikat Bujqësore, Agjencia e Statistikave të Kosovës ka publikuar të dhëna për Kulturat vjetore Bujqësore, Prodhimtarinë Blegtorale dhe Statistikat e Pemëtarisë. Anketa e Ekonomive Bujqësore zhvillohet rregullisht dhe përputhet me standardet e ACQUIS. Anketa e fundit e Strukturës së Fermës u zhvillua në vitin 2014, kurse e reja nuk u planifikua deri në vitin 2024. Indekset e Çmimeve Bujqësore dhe Llogaritë Ekonomike për Bujqësinë publikohen në baza të rregullta. Bilanci i ofertës dhe Indeksi i Punës në Bujqësi ende nuk publikohen në baza të rregullta. Transmetimi i statistikave të disponueshme të bujqësisë në Eurostat bëhet përmes Sistemit Informativ Elektronik për Administrimin dhe Menaxhimin e Skedarëve të të Dhënave (EDAMIS).

Statistikat e Energjisë dhe Mjedisit janë pjesërisht në përputhje me ACQUIS. Gjatë periudhës raportuese, Agjencia e Statistikave të Kosovës ka shkurtuar afatet për publikimin e rezultateve të Bilancit energjetik dhe ka rritur numrin e produkteve statistikore të dërguara në Eurostat, por nevojiten përmirësime të mëtejshme në këtë fushë. Statistikat e Konsumit të Energjisë për sektorët e banimit, shërbimeve dhe transportit janë mbledhur, por rezultatet nuk publikohen rregullisht. Të dhënat mujore dhe pjesa mujore e burimeve të ripërtëritshme nuk dërgohen në Eurostat. Mungesa e treguesve të efikasitetit të energjisë vazhdon të jetë pengesë për raportimin e kursimeve të energjisë. Statistikat për Mbeturinat dhe Ujin publikohen rregullisht. Statistikat e Emetimit të Gazrave Serrë mbledhen, por informacioni nuk publikohet rregullisht. Statistikat e tjera Mjedisore si Llogaritë e Emetimeve në Ajër, Taksat e ndërlidhura me Mjedisin sipas Aktivitetit Ekonomik, Shpenzimet për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Bilancet e Rrjedhës Materiale nuk janë publikuar ende.

➤ Statistikat e Ministrisë përgjegjëse të Financave

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) prodhon statistika, si pjesë e aktiviteteve të tyre të zakonshme. MFPT ka për mision të bëjë parashikime dhe analiza për ta mbështetur procesin e vendimmarrjes, lidhur me formulimin e politikave ekonomike. Një nga detyrat më të rëndësishme të MFPT-së është përgatitja e buxhetit të shtetit, menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore. Objektivi kryesor është përgatitja e analizave më të besueshme mbi zhvillimet aktuale ekonomike dhe dhënia e

këshillave me kohë ndaj goditjeve të mundshme, me të cilat mund të përballet ekonomia e Kosovës. MFPT është e ngarkuar për të monitoruar, analizuar dhe për të bërë kërkime, lidhur me trendët makroekonomike dhe ngjarjet aktuale në Kosovë. Po ashtu, të përgatisë parashikime afatmesme për zhvillimin ekonomik nën skenarë të ndryshëm të politikës ekonomike. Gjithashtu, MFPT ofron raporte përmbledhëse mbi zhvillimet makroekonomike dhe politikave ekonomike, parashikimeve të variablave kryesore makroekonomike dhe sektoriale, të cilat do të shërbejnë si të dhëna për modelin makroekonomik dhe debate të politikave ekonomike. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e politikës fiskale të Qeverisë.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e informon publikun për përmirësimet e mundshme në planin e ardhshëm afatmesëm dhe për performancën financiare të Qeverisë. MFPT është duke e zgjeruar përdorimin e standardeve ndërkombëtare dhe teknologjive, për ta bërë më të lehtë dhe më të arritshëm në kohë informacionin mbi pagesat që ndodhin në vend gjatë një dite. Këto të dhëna janë paraqitur çdo muaj në seritë kohore, ku paraqiten të gjitha të hyrat dhe pagesat nga Buxheti i Kosovës. Këto të dhëna janë të publikuara në ueb faqen e MFPT-së.

➤ Statistikat e Bankës Qendrore

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është subjekt juridik publik me kompetencë të plotë bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në Ligjin për BQK-në. BQK ka pavarësi dhe autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese si dhe është institucioni kyç, pjesëmarrës dhe rregullator në Sistemin Financiar të Kosovës. Objektivi parësor i BQK-së është

të nxisë dhe të mbajë një Sistem Financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Objektiva të tjera të BQK-së janë (2) të kontribuojë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore; (3) të mbështesë politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë; dhe (4) të veprojë në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar shpërndarjen efikase të resurseve.

BQK, sipas mandatit Ligjor përpilon Statistikat Monetare e Financiare (SMF) dhe Statistikat e Sektorit të Jashtëm (SSJ) të Ekonomisë së Kosovës. SMF mbulojnë kryesisht Statistikat e Sektorit Financiar, siç janë të dhënat për Bankën Qendrore, Bankat Komerciale, Kompanitë e Sigurimeve, Fondet e Pensioneve, Institucionet Mikrofinanciare dhe ndihmësit e tjerë financiar. Kurse, SSJ mbulojnë kryesisht Statistikat e Bilancit të Pagesave, Pozicionet e Investimeve Ndërkombëtare, Statistikat e Borxhit të Jashtëm, Rezervat Ndërkombëtare dhe Statistikat e Investimeve Direkte, Remitencat, Letra me Vlerë Jashtë Vendi, etj.

Departamenti i Statistikës në BQK ka filluar zhvillimin e Statistikave të Llogarive Financiare. Llogaritë Financiare janë një modul i ri i statistikave që rekomandohen nga organizatat financiare ndërkombëtare. Si pjesë e pavarur e Llogarive Kombëtare, Llogaritë Financiare ofrojnë një pamje të plotë, gjithëpërfshirëse të situatës financiare dhe marrëdhënieve financiare në mes të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, përfshirë dhe marrëdhëniet me jo-rezidentët. Nga katër sektorët e ekonomisë që duhet të mbulohen në Statistikat e Llogarive Financiare, deri më tani Departamenti i Statistikës në BQK ka arritur të përgatit Statistikat e Llogarive Financiare për sektorin financiar sipas nën sektorëve (bankat komerciale, kompanitë e sigurimit, fondet pensionale, ndërmjetësitë tjerë financiar dhe ndihmësit financiar) dhe sektorin e jashtëm. Burimet e të dhënave për këta dy sektorë ekzistojnë brenda BQK-së, ndërsa burimet e të dhënave për sektorin e korporatave jo-financiare dhe ekonomive familjare si dhe sektorin qeveritarë, ekzistojnë në institucionet tjera me të cilat kërkohet bashkëpunim përmes Marrëveshjes së Mirëkuptimit, e cila është në proces të përgatitjes.

BQK ka autoritetin për t'i siguruar të dhënat e nevojshme statistikore. Ky aspekt ligjor është i rregulluar me Ligjin për BQK-në dhe i plotësuar me dy rregullore përkatëse për grumbullimin e informatave statistikore. Rregulloret janë të miratuara nga Bordi i BQK-së, bazuar në Ligjin për BQK-në.

Përpilimi dhe publikimi i statistikave nga Departamenti i Statistikave (DS) i BQK-së bëhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare dhe në praktikat më të mira të vendeve të tjera. DS bashkëpunon ngushtë me njësitë relevante të BQK-së dhe palët e tjera brenda dhe jashtë vendit për të përgatitur statistika të sakta e të besueshme, si dhe për ta avancuar më tej Sistemin Statistikor.

➤ Statistikat e Institucioneve tjera

Ekzistojnë edhe ofrues të tjerë të të dhënave, që përdoren për prodhimin e Statistikave Zyrtare në Kosovë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit e cila mbledhë dhe përpunon të dhëna për numrin e shkollave, nxënësve dhe personelit arsimor në arsimin para universitar Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik janë përgjegjës për regjistrimin e numrit të institucioneve shëndetësore, pacientëve, mjekëve dhe sëmundjeve, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural posedon të dhënat e vreshtarisë, të dhënat e subvencioneve në bujqësi dhe të dhëna tjera administrative. Ish Ministria e Punës tani pjesë e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është përgjegjëse për të dhënat e emigracionit. Si dhe institucione tjera, megjithatë, ofrues tjetër i Statistikave Zyrtare mund të jetë vetëm institucioni, i cili merr autorizimin nga ASK-ja për plotësimin e kriteve për prodhimin e Statistikave Zyrtare.

➤ Sfidat e Statistikave zyrtare

Sfida Institucionale	
1	Buxheti i Agjencisë së Statistikave Zyrtare
2	Mungesa e personelit të mjaftueshëm, të trajnuar të ASK
3	Koordinimi i integruar në prodhimin e statistikave në mes të departamenteve të ASK
4	Bashkërendimi me institucionet prodhuese të statistikave (MF, BQK, etj.)
5	Bashkëpunimi me institucionet për prodhimin e statistikave
6	Mungesa e protokolleve për menaxhimin e të dhënave administrative
7	Bashkëpunimi i ASK me EUROSTAT
8	Subjektiviteti ndërkombëtar i ASK
9	Digjitalizimi i ASK
10	Mungesa e sistemeve funksional elektronik që do të siguronin statistikat e plota dhe të përditësuara, në përputhje me standardet.
11	Kapacitetet njerëzore ë pamjaftueshme për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore
Produktiviteti i ASK	
1	Rritja e numrit të produkteve të ASK
2	Rritja e numrit të publikimeve të ASK
3	Rritja e numrit të variablave të prodhuara nga ASK
4	Modernizimi i qasjes në mbledhjen e të dhënave statistikore
5	Rritja e efikasitetit të ASK në prodhimin e statistikave (man days për produkt
6	Rritja e cilësisë së produkteve të ASK
7	Rritja e qasjes publike të produkteve të ASK

5. Objektivat Strategjike të Programit të Statistikave Zyrtare 2024-2028

OBJEKTIVI I STRATEGJIK 1	Avancimi i kapaciteteve institucionale dhe modernizimi i proceseve përmes digjitalizimit
OBJEKTIVI I STRATEGJIK 2	Fuqizimi i koordinimit dhe bashkëpunimit institucional në Sistemin e Statistikave të Kosovës
OBJEKTIVI I STRATEGJIK 3	Rritja e numrit të statistikave dhe shkurtimi i afatit të prodhimit të tyre
OBJEKTIVI I STRATEGJIK 4	Rritja e cilësisë dhe besueshmërisë së statistikave nëpërmjet harmonizimit të mëturës me standardet ndërkombëtare

5.1 Treguesit e Objektive Strategjike

Agjencia e Statistikave të Kosovës ka zhvilluar Treguesit e Objektive Strategjike bazuar në parime raportimit të tyre sa më korrekt dhe të cilët përcaktojnë nivel të pranueshëm të përcaktimit të synimeve që do të arrihen bazuar në vlerat bazë.

Objektivi Strategjik	Treguesi	Vlera bazë	Vlera e synuar
1 Avancimi i kapaciteteve institucionale dhe modernizimi i proceseve përmes digjitalizimit	<u>Treguesi:</u> Nr. i ditëve për produkte statistikore	(2023) 5937 ditë ¹⁰	(2028) -10%
	<u>Burimi:</u> ASK	76 produkte	
	<u>Treguesi:</u> Numri i statistikave të prodhuara bazuar në sistem të unifikuar digjital	(2023) 0%	2025 10%
	<u>Burimi:</u> Raportet e ASK		2026 20% 2027 40%

¹⁰ Numri 5937, në vitin 2022 është për të gjitha produktet 76, ndërsa për produktet krahasuese në vitin 2022/2021 është 5303 për 54 produkte krahasuese.

		<u>Treguesi:</u> Numri i burimeve të reja administrative të përdorura për produkte statistikore	(2023) 42	(2028) 56
2	Fuqizimi i koordinimit dhe bashkëpunimit institucional në sisteme statistikave të Kosovës	<u>Burimi:</u> ASK, MFPT, BQK <u>Treguesi:</u> Numri i burimeve administrative të harmonizuara me kriteret e ASK për prodhimin e statistikave administrative	(2023) 23	2027 28
		<u>Burimi:</u> Raportet e ASK-së		
		<u>Treguesi:</u> Numri i produkteve të reja të botuara gjatë një viti kalendarik sipas kalendarit të publikimeve.	2023 76	2028 91
		<u>Burimi:</u> Ueb-faqja e ASK		
3	Rritja e numrit të produkteve dhe frekuencës së produkteve ekzistuese të Statistikave Zyrtare	<u>Treguesi:</u> Nr. i frekuencës së publikimevetë produkteve ekzistuese gjatë një viti kalendarik (nga vjetore në 3 mujore, në 1mujore) <u>Burimi:</u> Raporti vjetor i ASK	2023 9, mujore; 18, TM 44, vjetore 5, dy vjeçare	2028 +20% mujore dhe TM
		<u>Treguesi:</u> Rritja e tabelave në platformën ASKDATA	2023 1500	2028 1800
		<u>Burimi:</u> ASK		
4	Rritja e cilësisë dhe besueshmërisë së statistikave zyrtare dhe harmonizimi i më tutjeshëm i tyre me standardet evropiane dhe ndërkombëtare	<u>Treguesi:</u> Përfshirja e Kosovës në indikatorët e performancës statistikore të Bankës Botërore. <u>Burimi:</u> Ueb-faqja e Bankës Botërore <u>Treguesi:</u> Rritja e nivelit të harmonizimit të statistikave me kërkesat e Eurostat / Përfshirja e produkteve të ASK në të dhënat statistikore të Eurostat <u>Burimi:</u> Shifrat Kryesore për vendet në zgjerim Eurostat	(2023) Jo (2023) 50-60%	2028 Po 2028 75-80%

➤ **Objektivi Strategjik 1. Avancimi i kapaciteteve institucionale dhe modernizimi i proceseve përmes digjitalizimit**

Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitet e fundit ka bërë përparime substanciale në çdo sferë të funksionimit të saj. Për më tepër, ASK ka arritur të vendosë edhe Sistem Statistikor të konsoliduar, në pothuajse të gjitha komponentat e saj. Meqenëse, në periudhën e ardhshme të Programit të Statistikave Zyrtare 2024-2028, synohet të bëhen përmirësime të mëtutjeshme me theks në një koordinim më të mirë të institucioneve prodhuese dhe burimeve të të dhënave, zgjerimin e gamës dhe frekuencës së produkteve statistikore, si dhe rritjen e cilësisë së statistikave. ASK duhet të ndërmarrë disa veprime për avancim institucional të saj në mënyrë që të përballë dhe të ketë kapacitete për zbatimin e reformave të synuara.

Prandaj, ASK për të ndërmarrë këto reforma duhet të rrisë kapacitetet e saja humane, me staf të shtuar në të gjitha Departamentet, po ashtu të zhvilloj bazën ligjore për angazhime të shërbimeve humane të përkohshme sipas nevojës dhe projekteve që planifikon. Për të rritur kapacitetet e humane, ASK së pari duhet të plotësojë pozitën e lira që ka sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023-24 dhe projeksionet për dy vitet tjera. Për më tepër, ASK ka bërë kërkesë për rritje të ndarjeve buxhetore në zërin e pagave dhe mëditjeve për akomodimin e kërkesës për 52 staf shtesë, të cilat ASK synon që ti punësojë gjatë viteve të ardhshme.

Njëkohësisht, ASK do të angazhohet që stafi i saj të jetë mirë i trajnuar dhe i gatshëm të ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e synimeve për ngritjen e produktivitetit dhe cilësisë së produkteve të ASK. Për të ndërmarrë këto reforma, ASK do të mundësojë që stafi i saj të jetë i kualifikuar dhe profesional, duke zbatuar kriteret dhe standardet e nevojshme për barazi gjinore.

Për të arritur synimet e përcaktuara me Programin e Statistikave Zyrtare 2024-2028, ASK përveç rritjes së burimeve njerëzore, ajo duhet të ndërmarrë veprime në ngritjen e kapaciteteve të saja digjitale. Kjo do të bëhet nëpërmjet investimeve në funksionalizimin e një qasje të deponimit të të dhënave statistikore, dhe ndërlikohjes së tyre me fushat dhe Departamentet e ndryshëm në ASK. Qëllimi kryesor i këtij objekti është përfundimi i mëtutjeshëm i sistemit statistikor në Kosovë, duke mundësuar zhvillimin e informacioneve statistikore të besueshme, cilësore dhe me kohë dhe duke lehtësuar dhe përmirësuar vendimmarrjen. Në këtë fazë Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka nevojë për mbështetje të mëtutjeshme për të përmirësuar saktësinë, kohën dhe besueshmërinë e të dhënave në mënyrë që të jenë në përputhje me standardet e Eurostat-it.

Prandaj, Objektivi Strategjik Nr.1 "Avancimi i kapaciteteve institucionale dhe modernizimi i proceseve përmes digjitalizimit" përcakton dy objektiva specifike për të siguruar udhëzime më të sakta për përcaktimin e një grupi veprimesh që do të zbatohen sipas këtij Programi të Statistikave Zyrtare. Objektivat specifike janë si vijon:

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1 Përmirësimi i performancës së Agjencisë së Statistikave të Kosovës përmes rritjes së kapaciteteve njerëzore

Në kuadër të këtij objekti përgjatë zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare 2023-2027 parashihen që të rritet performanca e Agjencisë së Statistikave të Kosovës përmes rritjes së kapaciteteve njerëzore që të mundë të përballojë dhe zbatojë reformat e planifikuara. ASK në kuadër të ligjit për ndarje buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës, ka të ndara mjete për 166 pozita. Në vitin 2023, ASK kishte të punësuar 137 zyrtarë dhe ky numër do të vazhdojë të bie si rrjedhojë e pensionimeve të personelit të ASK.

Me ndryshimet ligjore të kësaj fushe të miratuar në vitin 2022¹³ është hapur rruga që ASK të mundë të plotësojë numrin e miratuar të pozitave. Për më tepër, ASK ka kërkuar nga institucionet vendimmarrëse që numri i personelit të saj të rritet në 2024-25, në mënyrë që të arrijë të zbatojë kriteret e nevojshme të

EUROSTAT, të rrisë numrin e produkteve statistikore dhe frekuencën e publikimit të tyre, etj.

Përveç rritjes së numrit, ASK synon që personeli i saj, ai i ri e ashtu edhe personeli aktual, të jenë të gatshëm që të zbatojnë reformat e synuara. Për këtë arsyeje, ASK do të ndërmerre aktivitete trajnuese si brenda ASK-së, në bashkërendim me institucionet relevante si Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), Universitetin Hasan Prishtina dhe institucionet që janë burim i të dhënave administrative.

Objektivi Strategjik Nr. 1 – Avancimi i kapaciteteve institucionale dhe modernizimi i proceseve përmes digjitalizimit		
Objektivi specifik 1.1: Përmirësimi i performancës së Agjencisë së Statistikave të Kosovës përmes rritjes së kapaciteteve njerëzore		
Treguesit	Vlera Bazë 2023	Vlera e synuar 2028
Treguesi: Nr. i stafit të ASK Burimi: Raporti vjetor i ASK	139 ¹⁴	223
Treguesi: Numri i trajnimeve të stafit të ASK (seminare, punëtori, grupe punuese, vizita studimore, trajnime EST) Burimi: Raporti vjetor i ASK	114 ¹⁵	+10 % 126
Treguesi: Nr. i rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit (ZKA) të zbatuara nga ASK Burimi: Raporti i ZKA	2023 5	N r . 0
Treguesi: Rritja e efektivitetit të kostos për produktet statistikore Burimi: Raporti financiar i ASK	2023 164,400€	(-20%) 130,00 0€

¹² Në mars të vitit 2019 Qeveria e Kosovës ka miratuar projekt Ligjin Nr. 06/L-114 për zyrtar publik. Ky projektligj është sfiduar në Gjykatën Kushtetuese e cila ka pezulluar dhe rrjedhimisht ka shpallur pjesërisht të pa zbatueshëm ligjin. Shih për më shumë draft ligjin dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese në Gazetën Zyrtare në: <https://qzk.rks-qov.net/ActDetail.aspx?ActID=29923>

¹³ Po aty.

¹⁴ ASK ka të aprovuara me buxhet 166 pozita. Deri në fund të vitit 2023 pritet të pensionohen personel shtesë i ASK. Për shkak të ndryshimeve ligjore në Ligjin për Zyrtarë Publik, ASK nuk ka arritur të punësoj stafin e miratuar sipas buxhetit

¹⁵ Gjithsej 114 aktivitete ndërsa pjesëmarrës 148 sosh, shih për më shumë Raportin Vjetor të ASK.

Objektivi Strategjik Nr. 1 – Avancimi i kapaciteteve institucionale dhe modernizimi i proceseve përmes digjitalizimit

Objektivi specifik 1.1: Përmirësimi i performancës së Agjencisë së Statistikave të Kosovës përmes rritjes së kapaciteteve njerëzore

Veprimet e planifikuara	
1.1.1	Rishikimi i Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës
1.1.2	Hartimi i rregullores për angazhimin e ekspertëve për statistika specifike
1.1.3	Hartimi i një udhëzuesit që përcakton kushtet dhe kriteret për angazhimin e personelit mbështetës për mbarëvajtjen e aktiviteteve statistikore të rëndësishme të veçantë siç është Regjistrimi i Popullsisë Ekonomike Familjare
1.1.4	Identifikimi i nevojave për trajnim shtesë të stafit të ASK
1.1.5	Zhvillimi i një programi të trajnimit në kuadër të IKAP për fushën e statistikave
1.1.7	Krijimi i një qendre jo formale në ASK për trajnim që ofron trajnime për zyrtarë të ASK dhe personelin e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare
1.1.8	Zhvillim i pesë (5) moduleve trajnuese për statistika zyrtare në bashkërendim me IKAP
1.1.9	Zhvillimi i 10 trajnimeve (2xvit) të detyrueshme për stafin e ri të ASK
1.1.10	Zhvillimi i moduleve dhe mbajtja e 10 trajnimeve për shkathtësi në teknologji informative për statistika
1.1.11	Publikimi i moduleve të trajnimeve për statistika në ueb-faqen e ASK
1.1.12	Ndërlidhja e planit të ZKA me Planin Vjetor të Punës të ASK
1.1.13	Rritja e nivelit të shpenzimit të buxhetit të alokuar sipas ligjit për ndarjet buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës
1.1.14	Rritja e penetrimit të shfrytëzuesve të produkteve statistikore
1.1.15	Rritja e nivelit të kënaqshmërisë së përdoruesve me produktet statistikore

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.2. Rritja e kapaciteteve digjitale të ASK në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave

Procesi i prodhimit të produkteve statistikore që nga mbledhja e të dhënave, përpunimi dhe analizimi i tyre, prodhimi dhe shpërndarja e statistikave zyrtare kërkon një qasje të avancuar teknologjike. Prandaj, në kuadër të Programit të Statistikave Zyrtare 2024-2028, institucionet prodhuese të statistikave zyrtare si dhe ato burim i të dhënave administrative do të bashkërendojnë funksionet e tyre në prodhimin dhe shpërndarje të statistikave përmes proceseve moderne digjitale.

Avancimi digjital i procesit të prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave do të bëhet duke rishikuar infrastrukturën digjitale në dispozicion tek institucionet prodhuese dhe shpërndarëse të statistikave. Ky proces do të pasohet me ngritjen e një infrastrukture për deponimin e të dhënave statistikore, infrastrukturë që do të ndërlidhet me të gjitha proceset statistikore në ASK. Po ashtu kjo infrastrukturë do të ndërlidhet edhe me institucionet burim i të dhënave administrative në mënyrë që ASK dhe institucionet tjera prodhuese të statistikave zyrtare të kenë qasje në kohë realenë të dhëna statistikore.

Sistemi i integruar kërkon resurse shtesë financiare të cilat pritet të mbulohen përmes mbështetjes nga partnerët zhvillimor, përkatësisht Komisioni Evropian dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar. Gjithashtu, paralelisht duhet të trajtohet çështja e kapaciteteve të brendshme për të mundësuar funksionalizmin e një sistemi të tillë.

Rritja e kapaciteteve digjitale në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave do të bëhet duke u bazuar në avancimet e shpejta që janë duke u bërë në fushën e teknologjisë informative, dhe me synim që të mundësojë shpejtësi, saktësi, dhe shpërndarje më të lehtë të statistikave zyrtare.

Objektivi Strategjik nr. 1: Avancimi i kapaciteteve institucionale dhe modernizimi i proceseve përmes digjitalizimit		
Objektivi specifik 1.2: Rritja e kapaciteteve digjitale të ASK në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave		
Treguesit	Vlera bazë	Vlera e synuar
<u>Treguesi:</u> % e burimeve statistikore që rrjedhin nga sistemi i integruar i teknologjisë informative/regjistri bazë <u>Burimi:</u> Raporti vjetor i ASK-së	2023 0	2028 50%
<u>Treguesi:</u> % produkteve statistikore të bazuar në sistemin e integruar informativ/Regjistri bazë <u>Burimi:</u> Raporti vjetor i ASK-së	2023 0	2028 50%
Veprimet e planifikuara		
1.1.1	Inventarizimi i pajisjeve të teknologjisë informative në ASK dhe identifikimi i nevojave për pajisje të reja	
1.1.2	Vlerësimi i sistemeve ekzistuese (baza të të dhënave, aplikacione specifike) dhe përgatitja e rekomandimeve për avancimin e mëtutjeshëm	
1.1.3	Digjitalizimi i mbledhjes së të dhënave statistikore duke u bazuar në raportin e vlerësimit	
1.1.4	Identifikimi dhe përdorimi i aplikacioneve specifike për analizimin e të dhënave bazuar në regjistrin bazë	
1.1.5	Ndërlidhja e regjistrin bazë me statistika sektoriale/Departamente	
1.1.6	Krijimi i regjistrin bazë (Depo) për statistika të ASK-së	
1.1.7	Zvogëlimi i barrës së raportimit nga Departamentet e ASK	
1.1.8	Shpërndarja/publikimi i produkteve statistikore përmes kanaleve alternative përveç ueb - faqes së ASK	
1.1.9	Krijimi i sistemit për qasje më të lehtë të qytetarëve në produkte statistikore nëpërmjettabelave të kryqëzuara	
1.1.10	Rritja e sigurisë së pajisjeve digjitale të ASK nëpërmjet protokolleve për shfrytëzim, qasje, dhe ruajtje, duke përfshirë zbatimin e standardeve ISO 27000	
1.1.11	Plasimi i instruksioneve vizuale (video dhe infografika) për produkte statistikore të ASK	
1.1.12	Digjitalizimi i "Modelit i gjenerimit të punës së proceseve statistikore/ Generic statistical processes business model" (GSPBM)	
1.1.13	Zhvillimi dhe krijimi i WebGIS (geographical information system)	
1.1.14	Ndërtimi i platformës së monitorimit të anketave në terren.	
	Modernizimi i mëtejme i mbledhjes së të dhënave përmes metodave (CAPI, CATI,CAWI)	

➤ **Objektivi Strategjik 2. Fuqizimi i koordinimit dhe bashkëpunimit institucional në sistemin e statistikave të Kosovës**

Agjencia e Statistikave të Kosovës për të prodhuar statistika të mirëfillta të besueshme, me standarde të BE, dhe lehtë të qasshme për përdoruesit e tyre duhet të ketë qasje të pandërprerë në të dhëna administrative që plotësohen dhe mirëmbahen nga institucione qeveritare të Republikës së Kosovës.

ASK ka nënshkruar më së 17 Memorandume të Mirëkuptimit me institucione të ndryshme (shih listën më lartë), memorandume që në parim paraqesin qasjen dhe metodologjinë e qasjes në të dhëna administrative të këtyre institucioneve, shkëmbim të përvojave në inventarizimin e të dhënave, dhe përcaktimi i pikave të kontaktit. Në të shumtën e rasteve këto të dhëna janë të limituara vetëm në të dhëna të departamenteve të ndryshme të këtyre institucioneve apo edhe janë të vjetërsuara pasi që janë nënshkruar vite më parë kur edhe disa mekanizma institucional ose kanë qenë prerogativë të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ose nuk kanë qenë ende të themeluara. Prandaj, disa nga këto MeM duhet të rishikohen gjatë periudhës së ardhshme të zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare 2024-2028.

Për të vështirësuar situatën e qasjes së papenguar në të dhëna administrative është edhe fakti që disa institucione nuk kanë sisteme të vendosura për mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave që janë kompetencë e tyre. Prandaj, në rastin më të mirë, këto institucione shkëmbejnë të dhënat bazuar në sisteme manuale sipas kërkesës së ASK. Këto institucione duhet të themelojnë mekanizma digjital për evidentimin, mirëmbajtjen, dhe shpërndarjen e të dhënave të tyre. Në këtë rast, duke pas parasysh përkrahjen e madhe që ASK gjeneron nga institucione ndërkombëtare, si dhe ekspertizën e brendshme, mund të shërbejë si institucion udhëzues dhe kur është e mundur edhe ndihmues në vendosjen e mekanizmave të mirëfilltë për evidentimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave nga këto institucione.

Nga ana tjetër, përveç qasjes në të dhëna administrative, edhe ASK duhet të rrisë kapacitetet e brendshme të saj për të adresuar mangësitë në mbledhjen, mirëmbajtjen e sigurt, dhe përpunimin e mirëfillt të të dhënave që gjenerohen nga ASK apo edhe pranohen nga institucione tjera. Mu për këtë, ASK duhet të fillojë me rritjen e sistemit të sigurisë fizike si dhe asaj digjitale në kuadër të ASK. Për sa i përket qasjes digjitale, ASK do të angazhohet në koordinimin në kuadër të departamenteve si dhe ndërmjet produkteve të ndryshme statistikore që outputet e një departamenti apo një produkti statistikor të jenë edhe inpute të një departamenti apo procesi tjetër statistikor. Kjo do të arrihet duke funksionalizuar sistemin e vendosjes së një regjistri bazë (Depo) i cili shërben si one stop shop për të gjitha të dhënat statistikore të ASK-së.

Objektivi Strategjik i fuqizimit, koordinimit dhe bashkëpunimit institucional në sistemin e statistikave të Kosovës ka tri objektiva specifike, nëpërmjet të cilave synohet të zbatohet objektivi strategjik.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.1 – Vendosja e qasjes së integruar në prodhimin e statistikave në mes të departamenteve të ASK-së

Në funksion të rritjes së efikasitetit të departamenteve në ASK, do të punohet për të krijuar një qasje të integruar në hartimin dhe shpërndarjen e produkteve statistikore nga këto departamente. Nëpërmjet qasjes së integruar do të anashkalohen proceset manuale të bashkërendimit të departamenteve të ASK në prodhimin e statistikave zyrtare. Për më tepër, krijimi i data bazës (depoje të dhënave statistikore) së integruar në proceset e prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave do të mundësojë që Departamentet të jenë të ndërlidhura në funksionet e tyre të planifikimit të proceseve statistikore, prodhimin e statistikave zyrtare, dhe shpërndarjen e tyre. Përveç, data bazës së integruar, për të mundësuar një qasje të integruar të departamenteve, ASK do të hartojë procedura dhe standarde të operimit të bazuar në praktikatat ndërkombëtare që përcaktojnë gjithë procesin statistikor

Po ashtu, ASK do të hartojë dhe miratojë formularë standard që përcaktojnë proceset statistikore si brenda departamenteve të ASK, ashtu edhe në mes të Departamenteve të ASK.

Objektivi Strategjik nr. 2 –Fuqizimi i koordinimit dhe bashkëpunimit institucional në Sistemin e Statistikave të Kosovës		
Objektivi specifik 2.1: Vendosja e qasjes së integruar në prodhimin e statistikave në mes të departamenteve të ASK-së		
Treguesit	Vlera bazë	Vlera e synuar
Treguesi: Numri i MeM të nënshkruara me institucionet burim i të dhënave administrative Burimi: ASK	2023 (17)	2028 32
Treguesi: Numri i publikimeve dhe aktiviteteve statistikore të bazuaranë sistemin e integruar Burimi: Raporti vjetor i ASK	2022 0	2028 10
Treguesi: % i programeve të kryqëzuar në aplikacionin "R" ¹⁶ Burimi: Raporti vjetor i ASK	2023 0%	2028 20%
Veprimet e planifikuara		
2.1.1	Vlerësimi i sistemeve të teknologjisë informative (duke përfshirë bazat e të dhënave në përdorim, veglave specifike për statistika dhe sistemeve të tjera shtesë)	
2.1.2	Hartimi dhe miratimi Procedurave Standarde të Operimit për produktet statistikore	
2.1.3	Krijimi i një sistemi të integruar në qasje të dhënave statistikore	
2.1.4	Caktimi i zyrtarëve që kanë qasje në sistemin e integruar të të dhënave statistikore	
2.1.5	Hartimi dhe miratimi i manualit për rrjedhën e punës (workflow)	
2.1.6	Trajnimi i analistëve të statistikave në aplikacionin "R"	
2.1.7	Hartimi i formularëve për produktet statistikore	

Objektivi Strategjik nr. 2 –Fuqizimi i koordinimit dhe bashkëpunimit institucional në Sistemin e Statistikave të Kosovës	
Objektivi specifik 2.1: Vendosja e qasjes së integruar në prodhimin e statistikave në mes të departamenteve të ASK-së	
2.1.8	Standardizimi i formularëve (templates) statistikore të natyrës së ngjashme për të gjitha Departamentet
2.1.9	Hartimi i kodit të praktikës për programim
2.1.10	Arritja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit trepalësh: ASK, BQK dhe MFPT

¹⁶ "R" është një gjuhë programuese që përdoret si mjet për analizimin e të dhënave dhe softuer statistikor.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2 – Fuqizimi i bashkëpunimit me institucione prodhuese dhe përdoruese të statistikave

Një nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane është qasje e papenguar e autoriteteve statistikore (Agjencisë së Statistikave të Kosovës) në të dhëna administrative që prodhohen nga institucione qeveritare dhe jo qeveritare.¹⁷ Për më tepër autoritetet qendrore të statistikave duhet të jenë të përfshirë që nga iniciimi i mbledhjes së të dhënave administrative, forma e mbledhjes dhe zhvillimi i tyre, shpërndarja, etj.

Kosova ka vendosur bazë të mirëfilltë ligjore për dhënien e kësaj kompetence ASK-së në pasjen e një qasje të pandërprerë në të dhëna administrative duke detyruar institucionet që të vendosin të dhënat e tyre në dispozicion të ASK.¹⁸ Për më tepër, i njëjti ligj në plotësim-ndryshim, përfshin parimin 2 të kodit të praktikës të statistikave evropiane fjalë për fjalë duke qartësuar faktin që ASK ka qasje të pandërprerë si dhe mund të vendosë edhe për metodologjinë e mbledhjes, mirëmbajtjes dhe shpërndarjes së të dhënave administrative.¹⁹

Mirëpo deri më tani ASK ka pasur vështirësi në qasje të pandërprerë në të dhëna administrative për arsye të ndryshme, thelbësore nga to janë pamundësia e institucioneve të mirëmbajnë të dhënanë formate të qasshme, nevoja për qartësime ligjore shtesë për qasje në këto të dhëna, si dhe krijimi i protokolleve të nevojshme për ruajtjen e të dhënave që vendosën në dispozicion të ASK.

Për të mënjeluar pengesat e deritanishme, ASK ka iniciuar procese të lidhjes së Memorandume Mirëkuptimi (MeM) me institucionet që janë burim i të dhënave administrative. Këto MeM do të qartësojnë procedurat e mbajtjes së të dhënave administrative nga ana e institucioneve prodhuesetë tyre, por po ashtu edhe përgjegjësitë e ASK në mirëmbajtjen e të dhënave pasi që një pjesë e tyre janë subjekt i sanksionimeve ligjore.²⁰

¹⁷ Parimi 2, mandati për mbledhje dhe qasjen në të dhëna i Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane paraqet obligimin e vendeve që të krijojnë bazë ligjore ku autoritetet statistikore kanë qasje të pandërprerë në të dhëna administrative. Për më shumë për kodin e praktikës së statistikave evropiane, shih në: <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-catalogues/-/ks-02-18-142>

¹⁸ Shih nenin 23 të Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës. Për më tepër shih: <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2782>

¹⁹ Shih nenin 12 për plotësim ndryshim i Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës në: <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2782>

²⁰ Këtu mund të merret shembull qasja në të dhënat e Agjencisë së Regjistrimit Civil ku ruajtja dhe mirëmbajtja e këtyre të dhënave është e rregulluar me disa ligje tjera, p.sh Ligji Nr. 04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil

Po ashtu ASK, me vendosjen e Sistemit të Regjistrimit Bazë (Depo të statistikave) të statistikave, do të angazhohet në vendosjen e një ndërlidhje të burimeve administrative me regjistrin bazë të ASK. Nëpërmjet kësaj qasje do të reformohet edhe metodologjia e mbledhjes, mirëmbajtjes, si dhe shpërndarjes së të dhënave statistikore nga institucionet që janë burim i të dhënave administrative.

Objektivi Strategjik 2: Fuqizimi i koordinimit dhe bashkëpunimit institucional në Sistemin e Statistikave të Kosovës		
Objektivi specifik 2.2: Fuqizimi i bashkëpunimit me institucione prodhuese dhe përdoruese të statistikave		
Treguesit	Vlera bazë	Vlera e synuar
Treguesi: Rritja e qasjes në burime administrative	2023 10	2028 30
Burimi: Raporti i ASK		
Treguesi: Numri i Grupeve Punuese ndërinstitucionale për statistika sektoriale	2023 3	2028 10
Burimi: Raporti i ASK		
Treguesi: Rritja e Nr. të anëtarëve të rinj të sistemit statistikor	2023 3	2028 5
Burimi: Raporti vjetor i KAS		
Veprimet e planifikuara		
2.1.1	Hartimi i SOP/PSO për qasje, mirëmbajtje, dhe përpunim të dhënave administrative	
2.1.2	Caktimi i zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e qasjes në të dhëna administrative	
2.1.3	Vendosja e sistemit të auditimit nga ASK të metodologjisë së prodhimit të statistikave administrative nga institucionet	
2.1.4	Caktimi i protokolleve për autorizimin e anëtarit të ri të SSK (ONAs)	
2.1.5	Hartimi i dokumentit për vlerësimin e kriterëve për statistika zyrtare	
2.1.6	Hartimi i dokumentit që përcakton funksionet dhe kriteret për anëtarët e bordeve përkatëse të statistikave sektoriale	
2.1.7	Hartimi i udhëzimeve dhe instruksioneve për stafin në mbrojtjen dhe menaxhimin e të dhënave statistikore	
2.1.8	Nënshkrimi i numrit të memorandumeve të bashkëpunimit me institucionet, burim i statistikave administrative	

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.3 – Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të ASK që kontribuon në avancimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës dhe promovimin e ASK-së

Sistemi Statistikor i Kosovës (SSK) tashmë është sistem i konsoliduar, pothuajse në shumicën e komponentëve të tij dhe korrespondon me zhvillimet rajonale të sistemit të statistikave. Duke marrë shkas nga këto avancime, dhe me synim që ASK të luaj rol pozitiv në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës, ASK synon të ndërmerr veprime që të promovojë bashkëpunimin e saj ndërkombëtarë.

Në dritë të kësaj, ASK synon që të iniciojë procedura për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare me institucione simotra si dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare. Nënshkrimi i marrëveshjeve me institucionet simotra do të gjeneroj bashkëpunim në fushat e produkteve

statistikore si shkëmbim të përvojave, asistencë në fusha të ndryshme, si dhe bashkërendim të aktiviteteve me theks në anëtarësimin e ASK në mekanizma ndërkombëtarë.

Po ashtu ASK synon që të identifikojë organizatat ndërkombëtare me të cilat mund të ketë shkëmbime dhe publikime të ndërsjella të të dhënave dhe produkteve statistikore. Prandaj, pjesë ekëtij objekti specifik janë planifikuar veprime që shpien në fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të ASK që kontribuon në avancimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës duke synuar që ASK të bëhet pjesë e mekanizmave relevant rajonal dhe ndërkombëtar në të njëjtin nivel me organizata simotra rajonale.

Objektivi Strategjik nr. 2 –Fuqizimi i koordinimit dhe bashkëpunimit institucional në Sistemin e Statistikave të Kosovës		
Objektivi specifik 2.3: Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të ASK që kontribuon në avancimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës dhe promovimin e ASK-së		
Treguesit	Vlera bazë	Vlera e synuar
Treguesi: Nr. i marrëveshjeve të mirëkuptimit me institucionet nacionale statistikore të vendeve tjera dhe organizata ndërkombëtare Burimi: ASK	2023 17	2028 34
Treguesi: Nr. i indikatorëve të përfshirë në publikimete Eurostat (Enlargement countries - statistical overview/Eurostat) Burimi: Raporti vjetorë i ASK	2023 127 ²¹	2028 152
Veprimet e planifikuara		
2.1.1	Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet nacionale të statistikave për shkëmbimin dhe harmonizimin e të dhënave	
2.1.2	Nënshkrimi i marrëveshjeve me organizata ndërkombëtare	
2.1.3	Shkëmbimi i përvojave me institucione nacionale statistikore	
2.1.4	Shkëmbimi i përvojave me organizata ndërkombëtare	
2.1.5	Identifikimi i organizatave prestigjioze për publikimin e të dhënave statistikore të ASK	
2.1.6	Ofrimi i të dhënave statistikore nga ASK për organizatat ndërkombëtare	

²¹ Deri në vitin 2021, nga gjithsej, 190 indikatorë, Kosova është e përfshirë me 127 apo 66.8%, Sipas Eurostat, të dhënat për vitin 2022, publikohen në Maj 2023 (Enlargement countries - statistical overview/Eurostat)

➤ **Objektivi Strategjik 3. Rritja e numrit dhe frekuencës së Statistikave Zyrtare të Kosovës**

Agjencia e Statistikave të Kosovës, është institucion i obliguar me ligj që të mbledhë, përpunojë dhe publikojë statistikën zyrtare, duke u zbatuar në standardet e Eurostat. Në zbatim të Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022, ASK ka pasur një rritje në produkte statistikore dhe në publikime statistikore krahasuar me programin paraprak. Shifrat e mëposhtme tregojnë produktivitetin dhe efikasitetin në rezultatet e arritura. Numri i publikimeve statistikore ka një rritje më tëmadhe, si rezultat i futjes në planin operativ të një numri të publikimeve me frekuencë mujore, sidomos gjatë vitit 2022. Të dhënat nga sistemi i SIPK-ut tregojnë në vlera nominale një rritje nga 120 në vitin 2017, në 171 publikime në fund të vitit 2022, respektivisht rritje me 42.5% në total, ndërsa mesatarisht në vit me 8.5%.

Në frymë të objektivit dhe nevojave që Kosova të ketë numër më të madh të produkteve dhe publikimeve statistikore, ASK, do të vazhdojë rritjen e produkteve të saj statistikore, publikimit të tyre, si dhe frekuencën e produkteve statistikore.

Në bazë të Planit të saj të prodhimit të statistikave, ASK deri më tani ka ofruar statistika zyrtare tëfushave të ndryshme sektoriale me frekuencë të publikimit në baza mujore, tremujore, vjetore, dyvjetore si dhe në raste të rralla në baza katër vjeçare, siç është Anketa e Buxhetit të Ekonomive Shtëpiake. Frekuenca e prodhimit të produkteve statistikore dhe publikimit të tyre do të vazhdojë tërritet edhe më tutje në zbatim të këtij Programi të Statistikave Zyrtare 2024-2028. Rritja e numrit të produkteve dhe frekuencës do të bëhet duke u bazuar në kërkesat e përdoruesve të brendshëm dhe ndërkombëtar.

Kjo objektivi strategjike ka vetëm një objektivi specifike dhe zbatimin e saj do të matet me treguesin në tabelën më poshtë dhe nëpërmjet aktiviteteve të planifikuara nga institucionet përgjegjëse.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.1: Plotësimi i kërkesave të përdoruesve të brendshëm dhe ndërkombëtarë të statistikave zyrtare

Rritja e numrit të produkteve dhe frekuencës statistikore në rend të parë do të bëhet për të informuar procesin e planifikimit të politikave vendore, përkatësisht plotësimin e treguesve të nevojshëm për planifikimin dhe monitorimin e politikave. Një aspekt tjetër me rëndësi është që Kosova të plotësojë numrin e publikimeve sipas kërkesave të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit(MSA-së) dhe në veçanti kërkesave që dalin nga Kompendiumi i Komisionit Evropian.

Për të arritur këto rezultate, fillimisht do të analizohen kërkesat e përdoruesve të brendshëm dhe ndërkombëtarë, dhe do të caktohet metodologjia për publikime të reja në përputhje me këto kërkesa. Është e nevojshme që për këtë të sigurohet koordinimi ndërinstitucional në caktimin e treguesve për publikime të reja sipas kërkesave të përdoruesve të brendshëm. Kjo do të mundësojë publikimin e treguesve të rinj për qëllime të planifikimit dhe monitorimit të politikave, përkatësisht plotësimin e nevojave për tregues të Planit Kombëtar për Zhvillim dhe strategji sektoriale.

Objektivi Strategjik nr. 3 – Rritja e numrit dhe frekuencës së Statistikave Zyrtare të Kosovës		
Objektivi specifik 3.1: Plotësimi i kërkesave të përdoruesve të brendshëm dhe ndërkombëtarë të statistikave zyrtare		
Treguesit	Vlera bazë	Vlera e synuar
Treguesi: Nr. i publikimeve të reja sipas kërkesave të Planit Kombëtar për Zhvillim Burimi: Raportin vjetor të ASK Raporti vjetor i zbatimit të Planit Kombëtar për Zhvillim (ZKM)	2023 0	2028 Së paku 10 tregues të rinjë
Treguesi: Nr. i publikimeve sipas kërkesës së Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA 2023-2027) Burimi:	2023 6	2028 27
Treguesi: Nr. i produkteve sipas kërkesave të paraqitura në Kompendiumin ²² (Përmbledhjen) e Eurostat Burimi: Raporti vjetor i ASK	2023 190	2028 +132
Veprimet e planifikuara		
3.1.1	Përgatitja e planit të veprimit për hartimin e publikimeve të reja	
3.1.2	Caktimi i metodologjisë për publikimet e reja në përputhje me kërkesat e përdoruesve ndërkombëtarë	
3.1.3	Koordinimi ndërinstitucional në caktimin e tregueseve për publikime të reja sipas kërkesave të përdoruesve të brendshëm	
	Publikimi i treguesve të rinjë për qëllime të planifikimit dhe monitorimit të politikave (plotësimi i nevojave për tregues të Planit Kombëtarë për Zhvillim dhe strategjitë sektoriale)	
3.1.4	Koordinimi ndërinstitucional në caktimin e tregueseve për publikime të reja sipas kërkesave të përdoruesve ndërkombëtarë	
3.1.5	Identifikimi i burimit të të dhënave administrative të disponueshme	
3.1.6	Sigurimi në qasje të pa penguar në të dhëna administrative	
3.1.7	Trajnimi i personelit të angazhuar në publikimet e reja	
3.1.8	Konsolidimi i statistikave të llogarive financiare duke mbuluar të katër sektorët ekonomikë	

²² Komependium është një dokument i publikuar nga Eurostat, në të cilën janë aspektet logjore, afatet kohore si dhe fushat e të dhënave që kërkojnë. Kompendium 2022, gjendja XK 190 nga 588 që kërkojnë, synimi deri në vitin 2027 mbulohen edhe 132 fusha me të dhëna të kërkuara.

➤ **Objektivi Strategjik 4. Rritja e cilësisë dhe besueshmërisë së Statistikave Zyrtare nëpërmjet harmonizimit të mëtutjeshëm me standardet ndërkombëtare**

Udhëzimet ndërkombëtare për përmbajtjen në fusha të caktuara të statistikave zyrtare janë dhënë kryesisht nga: OKB, BE, FMN, Banka Botërore, OECD, etj. Këto institucione zhvillojnë dhe mirëmbajnë metoda, standarde dhe klasifikime, që duhet të përdoren dhe duhet të ndiqen edhe nga Sistemi Statistikor i Kosovës. Këto institucione prodhojnë dhe shpërndajnë, statistika ndërkombëtare, andaj edhe duhet të shihen si përdorues kryesorë të statistikave zyrtare të Kosovës. Kosova synon integrimet evropiane, prandaj standardet e aplikuara janë të bazuara në këto udhëzime ndërkombëtare.

Prandaj, meqenëse për periudhën e ardhshme synimi është për ta fuqizuar dhe avancuar edhe më shumë këtë sistem, është shumë e rëndësishme, që në këtë periudhë, të rritet edhe më shumë cilësia e të dhënave statistikore. SSK është cilësor dhe i dobishëm, vetëm nëse arrihet një ndërveprim i ngushtë dhe konstruktiv me përdoruesit. Prandaj, ky Program strategjik synon zgjerimin e gamës dhe cilësinë e prodhimit të statistikave, duke u bazuar kryesisht në një ndërveprim të tillë. Në këtë synim do të ndërtohet një Sistem për Menaxhimin e Cilësisë, pavarësisht se janë bërë disa aktivitete të rëndësishme në këtë drejtim. Po ashtu, synohet që të realizohet një ndërveprim sistematik me përdoruesit, në kuptimin e efektshmërisë dhe dobisë së statistikave zyrtare për politik bërjen, për zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit, si dhe relevanca e tyre të organizatat ndërkombëtare. Prandaj, synohet të fuqizohet edhe më shumë bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Është me rëndësi të theksohet se objektivi i përgjithshëm i këtij Programi është avancimi dhe zhvillimi në një nivel më të lartë të SSK-së në aspektin e qëndrueshmërisë dhe të besueshmërisë statistikore. Prandaj, me qëllim të përmbushjes së kërkesave dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare, Sistemi Statistikor i Kosovës do të vazhdojë të zhvillohet, duke rritur produktivitetin dhe cilësinë e statistikave zyrtare në vend.

Kjo objektivë strategjike ka 2 objektiva specifike

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.1 – Harmonizimi i metodologjisë së produkteve statistikore me sistemin e Eurostat

Sipas Raportit të Progresit të Bashkimit Evropian, Kosova ka një nivel të pjesshëm të përgatitjes në fushën e statistikave. Vihet re se është bërë progres në përmirësimin e metodologjisë për mbledhjen e të dhënave dhe me ratifikimin dhe ndryshimin e ligjit për statistikat. Sidoqoftë është me rëndësi për Kosovën që të përmirësojë më tej koordinimin në nivelin teknik dhe të përmirësojë qasjen dhe përdorimin e burimeve të disponueshme të të dhënave administrative. Disa nga sfidat kryesore të të dhënave janë të lidhura me cilësinë e të dhënave për shkak të mungesës së standardizimit të përkufizimeve dhe metodologjive dhe disponueshmërisë së kufizuar të të dhënave. Duke pasur parasysh rëndësinë e të dhënave për zhvillimin e Kosovës, është thelbësore që këto çështje të adresohen në mënyrë të shpejtë. Kosova deri më tani ka arritur një nivel të kënaqshëm të përputhshmërisë me acquis të BE-së. Duke u bazuar në të dhënat e vitit 2021, nga 93 fusha statistikore të Acquis/Eurostat, 39 janë të mbuluar nga Kosova.

Me qëllim të adresimit të sfidave të theksuara më lartë, përmes kësaj objektive specifike synohet të rritet numri i klasifikimeve ndërkombëtare të aplikuara dhe numri i dataseve të harmonizuara dhe të publikuara nga Eurostat. Kjo në veçanti do të arrihet përmes fuqizimit të koordinimit me institucionet që janë burim i të dhënave administrative dhe plotësim ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore për zbatimin e klasifikimeve statistikore ndërkombëtare. Gjithashtu, duhet të zhvillohen udhëzues dhe standarde të cilësisë për produkte statistikore, të shoqëruar me trajnimin stafit të njësive prodhuese për publikimin e raporteve të kualitetit për produkte statistikore.

Me këtë synohet të arrihet gjithashtu standardizimi i të dhënave statistikore të ASK-së dhe përgatitja e udhëzuesve për dërgimin e të dhënave sipas formatit të dataseteve të EUROSTAT. Kjo do të përfshijë gjithashtu vlerësimin e akteve nënligjore të ASK për përputhshmërinë e tyre me standardet e BE-së dhe plotësim ndryshimin e tyre me qëllim të harmonizimit me acqui të BE-së.

Objektivi Strategjik nr. 4 – Rritja e cilësisë dhe besueshmërisë së Statistikave Zyrtare nëpërmjet harmonizimit të mëtutjeshëm me standardet ndërkombëtare		
Objektivi specifik 4.1: Harmonizimi i metodologjisë së produkteve statistikore me sistemin e EUROSTAT		
Treguesit	Vlera bazë	Vlera e synuar
Treguesi: Nr. i klasifikimeve statistikore ndërkombëtare të aplikuara Burimi: Raporti vjetor i ASK Raporti i Komisionit Evropian për Vendin	2023 8	2028 15
Treguesi: Nr. i Raporteve të Cilësisë të publikuara Burimi: Raporti Vjetor i ASK	2023 45	2028 70
Treguesi: Nr. i Dataseteve të dërguara në EUROSTAT Burimi: Raporti Vjetor i ASK	2023 2 752 914	2028 +140%
Treguesi: % e përafritimit me Acquis Burimi: Raporti vjetor i ASK Raporti i Komisionit Evropian për Vendin	2022 41%	2028 65%
Veprimet e planifikuara		
4.1.1	Identifikimi i klasifikimeve statistikore ndërkombëtare të përditësuara për zbatim nga ASK	
4.1.2	Hartimi i planit të veprimit për zbatimin e klasifikimeve statistikore ndërkombëtare	
4.1.3	Koordinimi me institucionet burim i të dhënave administrative për zbatim të klasifikimeve statistikore ndërkombëtare	
4.1.4	Hartimi i akteve normative për zbatimin e klasifikimeve statistikore ndërkombëtare	
4.1.5	Hartimi i udhëzuesve dhe standardeve për cilësi për proceset specifike në produktet statistikore	
4.1.6	Inventarizimi i raporteve të kualitetit për produktet statistikore	

Objektivi Strategjik nr. 4 – Rritja e cilësisë dhe besueshmërisë së Statistikave Zyrtare nëpërmjet harmonizimit të mëtutjeshëm me standardet ndërkombëtare

Objektivi specifik 4.1: Harmonizimi i metodologjisë së produkteve statistikore me sistemin e EUROSTAT

4.1.7	Plan veprimi për publikimin e raporteve të kualitetit për produktet statistikore
4.1.8	Trajnimi i stafit të njësive prodhuese për publikimin e raporteve të kualitetit për produkte statistikore
4.1.9	Zbatimi i cilësisë në bazë të modelit të GSBPM
4.1.10	Standardizimi të dhënave statistikore të ASK sipas formatit të dataseteve të EUROSTAT
4.1.11	Hartimi i udhëzuesit për dërgimin e të dhënave statistikore të ASK sipas formatit të dataseteve të EUROSTAT
4.1.12	Vlerësimi i akteve nënligjore të ASK për përputhshmërinë e tyre me ACQUIS
4.1.13	Plotësim ndryshimi i akteve nënligjore të ASK dhe harmonizimi i tyre me Acquis
4.1.14	Përpilimi dhe shpërndarja e statistikave të bilancit të pagesave sipas kërkesave të Eurostat në baza mujore me afatin t+44

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.2 – Përmirësimi i matjes, përdorimit dhe shpërndarjes së Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm

Për të matur progresin drejt Agjendës 2030, të Kombeve të Bashkuara, duhet të sigurohen të dhënatë besueshme, në kohë dhe të imtësishme për të treguar se ku po bëjmë përparim e ku jo. Pengesat ndaj sigurimit të të dhënave të besueshme dhe me cilësi të lartë për ndjekjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-ve), përfshijnë mungesën e përkufizimeve dhe metodologjivet standardizuara, të dhëna të kufizuara të zbërthyer ose të dhëna jo të plota, koordinimin e dobët, mungesën e depove qendrore për monitorim, dhe burimet e pamjaftueshme njerëzore dhe financiare për gjenerimin e të dhënave.

Sipas vlerësimit të shpejtë të integruar, hartëzimi gjithëpërfshirës i të dhënave të OZHQ-ve i ndërmarrë në Kosovë, tregon se ndryshon shumë shkalla në të cilën maten, ose në fakt janë lehtësisht të matshëm, treguesit e përafëruar me OZHQ-të. Ende nuk ka ndonjë mënyrë të akorduar ndërkombëtarisht për të matur rreth 36 nga treguesit e OZHQ-ve, të cilët klasifikohen si tregues të nivelit III. 14 tregues të tjerë duket se nuk janë relevantë për Kosovën, siç janë treguesit që lidhen me sëmundjet tropikale, gjymtimin e organeve gjenitale të grave, dhe resurset detare.²³

Ky vlerësim ka nxjerrë disa rekomandime të cilat janë marr parasysh nga institucionet e Kosovës dhe do të adresohen përmes kësaj objekteve specifike. Në rend të parë, ASK do të shqyrtojë treguesit që janë pjesërisht të disponueshëm apo ende jo të disponueshëm, për të përcaktuar pikat hyrëse për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin në kohën e duhur për këta tregues, për ta përshpejtuar progresin drejt Agjendës 2030.

Si rrjedhojë, do të ndërmerren hapa për të siguruar disponueshmërinë e të dhënave që ende nuk janë të disponueshme, të cilat mund të llogariten dhe publikohen bazuar në informatat e zotëruara tashmë nga institucionet. Një hap tjetër me rëndësi është konsolidimi në mënyrë sistematike i treguesve të OZHQ-ve për të cilët tashmë mbledhen të dhëna përmes anketave dhe të dhënave administrative, dhe njëkohësisht të raportojë progresin drejt tyre duke iu referuar treguesve specifikë të OZHQ-ve për referencë dhe përdorim të lehtë. Për të pasqyruar këtë më mirë, duhet të krijohet një bazë e të dhënave për OZHQ-të që është e lehtë për përdoruesit e jashtëm, në mënyrë që të rritet përdorimi i të dhënave.

Objektivi Strategjik nr. 4 – Rritja e cilësisë dhe besueshmërisë së statistikave zyrtare nëpërmjet harmonizimit të mëtutjeshëm me standardet ndërkombëtare

Objektivi specifik 4.2: Përmirësimi i matjes, përdorimit dhe shpërndarjes së Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG)

Treguesit		Vlera bazë	Vlera e synuar
Treguesi: Disponueshmëria e treguesve të OZHQ-ve ²⁴		2023	2028
Burimi: Raporti vjetor i ASK++		40	60
Veprimet e planifikuara			
4.2.1	Krijimi i platformës për publikimin SDG në ueb-faqen e ASK		
4.2.2	Monitorimi dhe përditësimi i platformës për publikimin e SDG në ueb-faqe të ASK		
4.2.3	Krijimi i një qendre (Hub)		
4.2.4	Hartimi i planit për përfshirjen e indikatorëve të SDG në produktet statistikore të ASK		
4.2.5	Riformulimi i sistemit të mbledhjes së të dhënave statistikore për përfshirjen e treguesve të SDG		
4.2.6	Koordinimi me institucione për të dhëna administrative për prodhimin e indikatorëve të SDG		
4.2.7	Identifikimi i indikatorëve që nuk janë në përputhje me metodologjinë e raportimit të SDG		
4.2.8	Trajnimi i stafit për prodhimin dhe raportimin e treguesve të SDG		

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.3 – Abonimi i Kosovës në Standardin Special të Shpërndarjes së të Dhënave të FMN-së (SDDS – Special Data Dissemination System)

Me qëllim të rritjes së transparencës, besueshmërisë dhe krahasueshmërisë ndërkombëtare të statistikave kombëtare ekonomike dhe financiare, ASK, BQK dhe MFPT do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për t'u abonuar në standardin Special të Shpërndarjes së të Dhënave të FMN-së (SDDS). Ky standard nënkupton avancim të SSK në një nivel më të lartë krahasuar me standardin aktua. Një avancim i tillë ngërthen në vete rritje të mbulueshmërisë, besueshmërisë dhe shpeshtësisë së publikimit të informatave statistikore duke siguruar shpërndarje në kohë dhe të saktë sipas specifikimeve të SDDS.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka krijuar dy korniza kryesore për standardet e shpërndarjes së të dhënave: Sistemi i Përmirësuar i Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme (eGDDS) dhe Standardi Special i Shpërndarjes së të Dhënave (SDDS). Këto korniza janë krijuar për të udhëhequr vendet anëtare në ofrimin e të dhënave ekonomike dhe financiare gjithëpërfshirëse, në kohë dhe të besueshme për publikun. Ky standard shtrin fushëveprimin në katër sektorët kryesor të ekonomisë, sektorin real, fiskal, financiar dhe të jashtëm. Aktualisht, Kosova merr pjesë në standardin e-GDDS (General Data Dissemination System). Avancimi në standardin SDDS nënkupton kërkesa më të mëdha për të dhënat ekonomike dhe financiare, periodicitet dhe frekuencë të përmirësuar për publikimin e indikatorëve të caktuar. Disa nga kërkesat shtesë krahasuar me standarding e-GDDS përfshijnë:

- Respektimin e kërkesave specifike të mbulimit të të dhënave, periodicitetit dhe afatit kohor;
- Shpërndarjen e të dhënave përmes faqes së të dhënave përmbledhëse kombëtare (NSDP);
- Sigurimin e metodologjisë së të dhënave dhe Kalendarit Paraprak të Publikimit (ARC) dhe
- Përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe masave të transparencës.

Rrjedhimisht, institucionet përgjegjëse të prodhimit të statistikave në Kosovë, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Financave, punës dhe Transfereve do të përkushtohen që të ndërmarrin veprimet e nevojshme duke i paraprirë një plan i veprimit që të adaptojnë kërkesat e mbuleshmërisë, periodicitetit dhe frekuencës së përpilimit dhe publikimit të indikatorëve të kërkuar në standardin SDDS. Ky abonim përbën një hap shumë të rëndësishëm për sistemin statistikor të Kosovës duke transferuar atë nga sistem i një vendi në zhvill në sistem të një vendi të zhvilluar që ka lidhje të rëndësishme financiare ndërkombëtare.

Objektivi Strategjik nr. 4 – Rritja e cilësisë dhe besueshmërisë së statistikave zyrtare nëpërmjet harmonizimit të mëtutjeshëm me standardet ndërkombëtare		
Objektivi specifik 4.3: Abonimi i Kosovës në Standardin Special të Shpërndarjes së të Dhënave të FMN-së (SDDS – Special Data Dissemination System)		
Treguesit		Vlera bazë
		Vlera e synuar
Veprimet e planifikuara		
4.3.1	Përpilimi i indeksit të prodhimit	
4.3.2	Përpilimi i PPI	
4.3.3	Përgatitja dhe raportimi i të dhënave Operacionet e Qeverisë Qendrore	
4.2.4	Përmirësimi i frekuencës së publikimit të statistikave të Aseteve Rezervë Zyrtare	

6. Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit

Monitorimi i zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare është i rregulluar sipas Udhëzimit Administrativ 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit.

Për zbatimin e Programit, ASK është përgjegjëse që duke u bazuar në objektivat strategjike dhe specifike të programit, të hartojë Planin Vjetor të Punës. Duke u bazuar në planet vjetore ASK është përgjegjëse të monitorojë zbatimin e Programit dhe të hartojë raportet vjetore.

➤ Koordinimi institucional

Me qëllim të koordinimit institucional për të siguruar zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare të Kosovës, duhet të përcaktohen strukturat koordinues me rol për mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë, mbledhjen e të dhënave, dhe përpilimin e raporteve të progresit. Strukturat koordinues në këtë kontekst janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe kanë përgjegjësi të caktuara në fushën e statistikave zyrtare.

Duke u bazuar në ligjin për statistikat zyrtare, struktura koordinuese për Programin e Statistikave Zyrtare, ndahet në këtë mënyrë:

- Këshilli i Statistikave të Kosovës – që ka përgjegjësi Përgjegjësia të këshillojë në përgatitjen e programit të statistikave zyrtare, planet vjetore dhe në zhvillimin dhe funksionimin e përgjithshëm të ASK-së dhe të këshillojë për harmonizimin dhe koordinimin e produkteve statistikore brenda Sistemit Statistikor të Kosovës. Në këtë kontekst Këshilli i Statistikave gjithashtu monitoron dhe vlerëson zbatimin e Programit të Statistikave.
- Në nivelin teknik, Kryeshefi i ASK në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit krijon një grup koordinues ndërinstitucional për të siguruar monitorimin e rregullt të zbatimit të programit dhe planeve vjetore, përgatitjen e raporteve dhe kryerjen e vlerësimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare të programit. Grupi koordinues ndërinstitucional përbëhet nga institucionet që kanë

përgjegjësi në zbatimin e objektivave të programit, dhe të tjerë akterë të rëndësishëm.

- Sekretariati i Grupit koordinues caktohet Departamenti përgjegjës për politika, planifikim dhe koordinim në kuadër të ASK-së. Sekretariati është mekanizimi kryesor që siguron zbatimin, monitorimin dhe raportimin cilësor dhe me kohë duke mbledhur të dhëna dhe informacione nga institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për zbatimin e Programit.
- Përgatitja e raporteve të rregullta gjashtëmujore dhe vjetore mbi zbatimin e Programit, përmes Planeve Vjetore të ASK-së, do të bëhen nga Sekretariati i grupit koordinues institucional. Pas shqyrtimit të raporteve, Sekretariati ia dorëzon Kryeshefit të ASK-së, i cili është përgjegjës që ta paraqes para Këshillit të Statistikave të Kosovës.
- Pas shqyrtimit dhe miratimit nga Këshilli i Statistikave, raporti për zbatimin e Programit idorëzohet Zyrës së Kryeministrit.

➤ **Monitorimi dhe raportimi i Programit**

Korniza e monitorimit të zbatimit të Programit përfshin tregues të performancës në nivel të ndikimit ose rezultateve. Përmes këtyre treguesve synohet të bëhet matja e zbatimit të objektivave strategjike dhe specifike. Përzgjedhja e treguesve është bazuar në nevojën për vendosjen e një kornize të mirëfilltë të planifikimit dhe menaxhimit të sistemit statistikor të Kosovës. Në këtë drejtim janë përdorur tregues në dy nivelet e objektivave dhe reflektojnë ndikimin e intervenimeve. Për të siguruar cilësinë e tyre, përzgjedhja e treguesve është bazuar në kriteret e njohura ndërkombëtare, në mënyrë që ata të jenë të qartë, specifik, të tregojë në mënyrë të qartë drejtimin ndryshimit të synuar, burimi i të dhënave të jetë lehtësisht i identifikueshëm, metodologjia për llogaritjen e tyre të jetë lehtësisht e identifikueshme dhe kjo mundësi të monitorohet në baza periodike. Kjo na jep mundësi që planifikimi i veprimeve të sekuencohet në mënyrë logjike dhe mundëson krahasimin e Kosovës me vendet tjera.

Programi krahas objektivave të përgjithshme dhe specifike të shoqëruara me tregues të ndikimit dhe rezultateve, paraqet një listë të veprimeve që duhet të ndërmerren për arritjen e atyre objektivave. Këto veprime do të shërbejnë si orientim për planifikimin e mëtutjeshëm të punës nga ana e ASK-së, përmes Planit Vjetor të Punës së ASK-së.

Në këtë drejtim duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 07/2018, ASK si institucion udhëheqës për zbatimin e Programit, përmes strukturave koordinuese të paraqitura më lartë, do të përgatisë dy lloje të raporteve:

- Raporti gjashtëmujor për zbatimin e veprimeve të paraqitura në Planin Vjetor të Punës së ASK-së
- Raportin vjetor mbi zbatimin e programit, i cili duhet të paraqes të dhëna më të hollësishme mbi zbatimin e objektivave strategjike, specifike dhe zbatimin e veprimeve.

➤ **Vlerësimi i ndërmjetëm dhe përfundimtar i Programit**

Vlerësimi i programit duhet të bëhet në dy faza, vlerësim i ndërmjetëm dhe vlerësim përfundimtar. Vlerësimi i ndërmjetëm dhe përfundimtar duhet të fokusohet në nivelin e zbatimit të veprimeve (efektiviteti), përshtatjen apo korrigjimin e ndërhyrjeve për të arritur rezultatet dhe objektivat e dëshiruara (rëndësia).

Duke u bazuar në kriteret për Vlerësimin e dokumenteve strategjike të përcaktuara në Manualin për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike, vlerësimi i ndërmjetëm i Programit duhet të bëhet në vitin 2026, kurse vlerësimi përfundimtar duhet të iniciohet në fund të vitit 2028.

